


MANUALI

PËR MBIKËQYRJEN E BUXHETIMIT GJINOR

inë financimin e ndryshimeve klimatike





Përgatitur nga:

M.Sc. Slavjanka Pejcinovska - Andonova, Inxhinieri Mjedisore
Ekspert për ndryshime klimatike

Gordana Nestorovska, Ekspert gjinor

"Ky publikimi është krijuar në kuadër të projektit "Rrjeti i Monitorimit të Buxhetimit Gjinor në Ballkanin Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë" me financim të Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Qëndrimet e shprehura në këtë studim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimet e ADA apo SIDA."

Content

Mësimi 1

Ndryshimet klimatike

Mësimi 2

Kuadri Ndërkombëtare për Ndryshimet
Klimatike

Mësimi 3

Financimi klimatik

Mësimi 4

Perspektiva gjinore për financimin e
ndryshimeve klimatike

HYRJE:

Udhëzuesi për mbikëqyrjen e buxhetimit gjinor në financimin e ndryshimeve klimatike është përgatitur në kuadër të projektit "Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies për barazinë gjinore në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi (Rrjeti i Mbikëqyrjes së buxhetimit gjinor, Faza II)." Projekti ndjek Rrjetin e Mbikëqyrjes së Buxhetimit Gjinor (RMBGJ) në Ballkanin Perëndimor dhe projektin e mëparshëm të suksesshëm të Moldavisë, të mbështetur nga ADA dhe SIDA që ka për qëllim përmirësimin e angazhimeve publike për veprimtari të përgjegjshme klimatike me ndjeshmëri gjinore, si dhe rritjen e financimit të disponueshëm për zbatimin e veprimtarive klimatike me ndjeshmëri gjinore në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në Moldavi.

Synimi kryesor i udhëzuesit është të përmirësojë kuptimin e shqetësimeve gjinore në çështjet e politikave për ndryshimet klimatike, si në perspektivën e përgjithshme, ashtu edhe në atë specifike të çdo vendi, si dhe të mbështesë Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) në përlogaritjen e përgjegjshmërisë gjinore të veprimtarive dhe politikave të financuara për ndryshimet klimatike.

Kërkesat për veprimtari klimatike me ndjeshmëri gjinore po bëhen gjithnjë e më të forta, veçanërisht që nga Plani i Veprimit Gjinor i Limës në kuadër të UNFCCC. Gjithashtu, ka dhe angazhime të bëra si pjesë e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (financuar nga Bashkimi Evropian, Institucionet Ndërkombëtare Financiare, financime nga buxheti vendor) dhe nga Kontributet Kombëtare të Pikësnyuara (KKP) në kuadër të Marrëveshjes së Parisit. Ka kërkesa të forta për drejtësi gjinore në veprimtaritë klimatike dhe për raportim të përmirësuar mbi përfshirjen gjinore në zhvillimin dhe zbatimin e përgjigjeve ndaj ndryshimeve klimatike nga shtetet anëtare.

Ky udhëzues duhet t'i ndihmojë Organizatat e Shoqërisë Civile (organizatat për të drejtat e grave, organizatat për të drejtat e burrave, organizatat e shoqërisë Civile që punojnë për mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, si dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë për zbatimin e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1325) në prezantimin e lidhjeve mes buxhetimit me ndjeshmëri klimatike dhe atij me ndjeshmëri gjinore.

Pjesa e parë e udhëzuesit shpjegon ndryshimet klimatike, faktorët dhe pasojat për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, si dhe rëndësinë e përfshirjes gjinore në politikat e ndryshimeve klimatike.

Pjesa e dytë është një pasqyrë e shkurtër e kuadrit ndërkombëtar për ndryshimet klimatike dhe e mënyrës së përfshirjes së perspektivës gjinore në këtë kuadër.

Pjesa e fundit përshkruan financimin e ndryshimeve klimatike dhe mjetet se si organizatat e shoqërisë civile mund ta aplikojnë buxhetimin me ndjeshmëri gjinore në financimin e ndryshimeve klimatike.

01

Ndryshimet klimatike



Termi klimë i referohet një grupi fenomenesh moti, pra, proceseve atmosferike që karakterizojnë gjendjen fizike mesatare të atmosferës në një vend të caktuar në glob.

Klima është e kushtëzuar nga: regjimi i rrezatimit diellor, regjimi i rrezatimit tokësor, rrymat e ajrit, lagështia e ajrit, dhe temperatura e ajrit dhe tokës. Klima përcaktohet edhe nga çarkullimi i atmosferës, rregullimi i sipërfaqes së tokës dhe ujit, zonat gjeografike, lartësia mbidetare, karakteristikat e nënshtresës etj.

Varësia e njerëzve nga moti, klima dhe mjedisi natyror mund të jetë një nga kushtet bazë për ekzistencën në një territor të caktuar. E njëjta gjë vlen edhe për ndikimin në prodhimin bujqësor dhe në blegtori, në kultivimin e kulturave pyjore, si dhe ndikimin e kushteve atmosferike në mjedis dhe në planifikimin hapësinor dhe urban.

Nga ana tjetër, bëhet gjithnjë e më e dukshme se ka lidhje midis ndikimit të veprimtarive njerëzore me rritjen e elementeve të gazrave serrë, ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike.

Ndryshimet klimatike janë një sfidë e madhe për të gjithë ne dhe tashmë po i ndjejmë intensivisht efektet e tyre si: rritja e temperaturës, ulja e reshjeve, shkrirja e akullnajave, rritja e nivelit të detit etj. Ndryshimet përfshijnë ngjarje të shpeshta të motit ekstrem si thatësitat, që sjellin rrezik për popullsinë, shkatërrojnë bujqësinë dhe kulturat njerëzore, si dhe kërcënojnë zhdukjen e shumë llojeve të bimëve dhe kafshëve.

“Ndryshimet klimatike” nënkuptojnë ndryshimet e klimës që i atribuohen drejtpërdrejt ose tërthorazi veprimtarive njerëzore, që ndryshojnë kompozitën e atmosferës globale dhe që i shtohen variabilitetit natyror të klimës që shihet gjatë periudhave të krahasueshme kohore.

Përkufizimi i UNFCCC-së për ndryshimet klimatike



1.1 Fjalorth i termave të ndryshimeve klimatike

Përshtatja

Përshtatja ose përgatitja e sistemeve natyrore ose njerëzore për një mjedis të ri ose në proces ndryshimi, që lehtëson dëmin ose shfrytëzon mundësi të dobishme.

Kapaciteti përshtatës

Aftësia e një sistemi për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike (përfshirë variabilitetin dhe ekstremet klimatike) për të zvogëluar dëmet potenciale, për të përfituar nga mundësitë, apo për të përballuar pasojat..

Aerosolët

Grimca të vogla ose pika të lëngshme në atmosferë që mund të thithin ose reflektojnë rrezet e diellit në varësi të përbërjes së tyre.

Dioksid karboni

Gaz i krijuar natyrshëm dhe nënprodukt i djegies së lëndëve djegëse fosile dhe biomasave, si dhe i ndryshimeve në përdorimin e tokës dhe proceseve të tjera industriale. Është gazi kryesor i shkaktuar nga veprimtaria njerëzore që ndikon në balancën rrezatuese të tokës. Është gazi referencë, në të cilin maten gazrat e tjerë të efektit serrë dhe për këtë arsye ka potencialin 1 për ngrohje globale.

Ekuivalenti i dioksidit të karbonit

Një masë metrike e përdorur për të krahasuar emetimet e gazrave të ndryshme të efektit serrë, në bazë të potencialit të tyre të ngrohjes globale (GWP).” Ekuivalentët e dioksidit të karbonit shpesh shprehen si “milionë tonë metrike të ekuivalentëve të dioksidit të karbonit (MMTCO₂Eq).” Ekuivalenti i dioksidit të karbonit për një gaz përftohet duke shumëzuar tonët e gazit me potencialin përkatës të ngrohjes globale (GWP).

MMTCO₂Eq = (milion metrikë tonë gazi) * (GWP-ja e gazit)

Klima

Në kuptim të cekët, klima përcaktohet zakonisht si “moti mesatar”, ndërsa në kuptim më rigoroz, ajo përcaktohet si përshkrimi statistikor i mesatares dhe variabilitetit të sasive përkatëse përgjatë një periudhë kohore që shtrihet prej muajsh deri në mijëra vjet. Periudha klasike është 3 dekada, sipas përcaktimit të Organizatës Botërore Meteorologjike (WMO). Këto sasia janë shpeshherë variabla sipërfaqësore si temperatura, reshjet dhe era. Klima, në një kuptim më të gjerë, është gjendja, përfshirë përshkrimin statistikor, e sistemit klimatik. Shihni motin.

Ndryshimet klimatike

Ndryshimet klimatike përfshijnë çdo ndryshim të rëndësishëm të klimës që zgjat për një periudhë të gjatë kohore. Me fjalë të tjera, ndryshimet klimatike përfshijnë ndryshime të mëdha në temperaturë, reshje, ose në modelet e erës, midis të tjerash, që ndodhin gjatë disa dekadave apo më shumë.

Shpyllëzimi

Përfshin ose proceset që çojnë në shndërrimin e tokave pyjore për përdorime jo pyjore. Shpyllëzimi kontribuon në rritjen e përqendrimit të dioksidit të karbonit për dy arsye: 1) djegia ose dekompozimi i drurit lëshon dioksid karboni; dhe 2) pemët, që më parë largonin dioksidin e karbonit nga atmosfera në procesin e fotosintezës, nuk janë më të pranishme.

Emetimet

Çlirimi i substancave (zakonisht gazra kur flasim për ndryshimet klimatike) në atmosferë.

Lëndë djegëse fosile

Një term i përgjithshëm për materialet organike të formuara nga bimë dhe kafshë të dekompozuar, të cilat janë konvertuar në naftë bruto, qymyr, gaz natyror, ose vajra të dendur nga ekspozimi ndaj nxehtësisë dhe presionit në koren e tokës gjatë qindra miliona viteve.

Temperatura mesatare globale

Llogaritja e temperaturës mesatare të ajrit në sipërfaqen e tokës, mesatarisht për të gjithë planetin.

Ngrohja globale

Rritja e fundit dhe vazhdueshme e temperaturës mesatare globale pranë sipërfaqes së Tokës.

Potenciali i ngrohjes globale

Masa e energjisë totale të përthithur nga një gaz i caktuar gjatë në një periudhë të caktuar kohore (zakonisht 100 vjet), krahasuar me dioksidin e karbonit.

Efekti serrë

Kapja dhe akumulimi i nxehtësisë në atmosferën (troposferë) pranë sipërfaqes së tokës. Një pjesë e nxehtësisë që shkon përsëri drejt hapësirës nga sipërfaqja e tokës përthithet nga avulli i ujit, dioksidi i karbonit, ozoni dhe gazra të tjera në të atmosferës, e më pas ri-rrezatohet sërish drejt sipërfaqes së tokës. Nëse përqendrimit atmosferike të këtyre gazrave serrë rriten, atëherë temperatura mesatare e atmosferës së ulët do të rritet gradualisht.

Gazra serrë (GHG)

Çdo gaz që përthith rrezatimin infra të kuq në atmosferë quhet gaz serrë. Gazrat serrë përfshijnë dioksidin e karbonit, metanin, oksidin e azotit, ozonin, klorofluorokarbonet, hidroklorofluorokarbonet, hidrofluorokarbonet, perfluorokarbonet dhe heksafluor squfuri.

Valët e nxehtësisë

Periudha e zgjatur e nxehtësisë së tepërt, shpeshherë e kombinuar me lagështinë e tepërt.

Lehtësimi

Ndërhyrja njerëzore për zvogëlimin e ndikimit të njeriut në sistemin klimatik; përfshin strategji për zvogëlimin e burimeve dhe emetimeve të gazeve serrë dhe përforcimin e depozitave të tyre.

Energjia e rinovueshme

Burimet energjetike që rimbushen natyrshëm si biomasa, ajo hidro, gjeotermale, diellore, era, energjia termike oqeanike, veprimi i valëve dhe baticës.

Energjia solare


Rrezatimi i dielli i aftë për të prodhuar ngrohtësi, për të shkaktuar reaksione kimike ose për të gjeneruar elektricitet. Sasia totale e energjisë diellore e marrë në Tokë është shumë më e madhe se kërkesat aktuale dhe të parashikuara për energji në botë. Nëse shfrytëzohet siç duhet, energjia diellore ka potencial për plotësimin e të gjitha nevojave për energji në të ardhmen.

Vulnerabiliteti

Niveli i ndjeshmërisë ose pamundësia e një sistemi për të përballuar efektet negative të ndryshimeve klimatike, përfshirë variabilitetin dhe ekstremet klimatike. Vulnerabiliteti është funksioni i karakterit, madhësisë dhe shkallës së ndryshimeve klimatike ndaj të cilit ekspozohet një sistem; ndjeshmëria; dhe kapacitetit i tij për t'u përshtatur.

1.2 Faktorët natyrore që ndikojnë klimë

Klima e tokës ndryshon, natyrisht, për periudha shumë të gjata kohore. Ndryshimet natyrore në klimë studiohen përmes gazeve të bllokuar në akull në vende si Grënlanda dhe Antarktika, ose përmes sedimenteve nga fundi i oqeanëve apo liqeneve. Unazat e pemëve dhe shtresat e shkëmbinjve ofrojnë gjithashtu informacion mbi gjendjen e klimës në të kaluarën. Nëpërmjet këtyre regjistrimeve, arrihen përfundime se klima e tokës ka ndryshuar edhe para se njerëzit dhe aktivitetet e tyre të fillonin në planet. Gjatë 400 000 viteve të fundit, klima e tokës ka ndryshuar nga periudha të ftohta akullnajore (epokat e akullnajave) në periudha më të ngrohta ndërakullnajore.



Gazrat serrë, si dioksidi i karbonit (CO₂) në atmosferën e Tokës, kanë efekte të ngjashme me serrën; ato e reflektojnë një pjesë të energjisë përsëri në Tokë në vend që ta lënë atë të largohet në hapësirë. Ky efekt serrë arrin temperatura mesatare prej 15°C, ndërsa pa të, Toka do të kishte temperaturë mesatare rreth -19°C dhe do të vuante nga temperatura aq ekstreme sa nuk do të kishte jetë në të.

Edhe pse duket se vullkanet janë shkaqet kryesore të rritjes së temperaturave, në fakt, duke hedhur lumenj llave të nxehtë nga 700 deri në 1.200 °C, ata gjithashtu lëshojnë sasi të mëdha gazi dhe grimcash në atmosferë, të cilat mund të bllokojnë përkohësisht rrezatimin diellor që arrin në sipërfaqen e Tokës kështu ftohur kështu planetin.

1.3 Aktivitetet antropogjene që ndikojnë në klimë dhe pasojat e ndryshimeve klimatike.


Me kalimin e kohës, që prej fillimit të formimit të banimeve dhe qyteteve të para, veprimtaritë si prerja e pyjeve, shfrytëzimi i tokës për kultivim dhe rritja e kafshëve, përdorimi intensiv i burimeve të energjisë që shkaktojnë ndotje kanë çuar në ndryshime klimatike. Me zhvillimin e qyteteve, ndërtimin e rrugëve, zhvillimin industrial dhe, si rrjedhojë, djegien e lëndëve djegëse fosile (naftë, qymyr dhe gaz natyror), si dhe ndryshimet në mënyrën e menaxhimit të tokës dhe bujqësisë (përdorimi i pesticideve, plehrave dhe substancave të tjera kimike), janë çliruar sasi të mëdha gazrash serrë.

Gazrat serrë janë natyrale dhe kur janë në sasinë e duhur, ato sjellin shumë përfitime për tokën. Gazrat serrë janë ato që e bëjnë jetën të mundur në tokë. Ata rrisin temperaturën e planetit tonë dhe pa to, do të ishte shumë ftohtë për të mbijetuar.

Shtatë gazrat serrë të renditur në Shtojcën A, që janë objekt i analizave brenda kornizës së Protokollit të Kiotos dhe që kontribuojnë në ndryshimet klimatike në nivel global janë:

- dioksidi i karbonit (CO₂),
- metani (CH₄),
- oksidi i azotit (N₂O),
- hidroklorofluorokarbonet (HFCs),
- perfluorokarbonet (PFCs),
- heksafluoridi i sqfurit (SF₆),
- trifluori i azotit (NF₃).

Trifluori i azotit u shtua për periudhën e dytë të pajtueshmërisë gjatë Raundit të Dohas.



Ka gjithashtu gazra sintetike të reja si klorofluorokarbonet (CFC) dhe halonet, të cilat janë zbuluar gjithashtu se kontribuojnë në efektin serrë. Parashikohet që emetimi i gazeve serrë do të vazhdojë të rritet në përputhje me rritjen e ekonomisë globale.

Gazrat serrë kontribuojnë në rritjen e efektit serrë, i cili ndikon drejtpërdrejt në ngrohjen e planetit tokë, gjë që ndodh duke shpërbërë ekuilibrin e energjisë mes sasisë së rrezatimit diellor që mbetet në Tokë dhe atij që reflektohet drejt hapësirës.

Në kohët moderne, pjesa më e madhe e gazrave serrë vjen nga prodhimi i energjisë elektrike (40% e të gjitha emetimeve të dioksidit të karbonit në SHBA vjen nga prodhimi i energjisë elektrike nga lëndët djegëse fosile). Rreth 65% e të gjithë energjisë elektrike në botë prodhohet nga turbina me avull me lëndë djegëse fosile.

Edhe transporti është konsumator i madh i energjisë dhe prodhues i gazeve serrë (rreth 20% e energjisë së përdorur në nivel global përdoret për transport). Transporti po bëhet gjithnjë e më i arritshëm dhe njerëzit po përdorin gjithnjë e më shumë makinat dhe aeroplanët në jetën e tyre të përditshme. Bota po bëhet gjithnjë e më e globalizuar dhe gjithnjë e më shumë produkte dhe mallra (plastika, tekstile, ushqim, mallra etj.) tregtohen dhe transportohen përmes trenave, kamionëve dhe anijes.

Sektori tregtar, pra, dyqanet, restorantet, hotelet, objektet e biznesit, qendrat tregtare janë konsumatorë të mëdhenj të energjisë. Ata përdorin energji për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, ndriçimin dhe pajisjet e tjera.

Sektori industrial përdor rreth 50% të energjisë së botës për prodhim (p.sh. fabrika që prodhojnë elektronikë, tekstile dhe pajisje shtëpiake elektrike, makineri mobilësh etj.), bujqësi, miniera dhe ndërtim etj. Industritë që punojnë me kimikate, metale (hekur dhe alumini), minerale, përpunimin e letrës dhe ushqimin përdorin shumë energji dhe kontribuojnë në krijimin e sasive të mëdha të gazeve serrë.

Pasojat e drejtpërdrejta të ndryshimeve klimatike janë:

- përmbytjet,
- thatësirat,
- erozioni i tokës,
- valët e të nxehtit dhe të ftohtit,
- temperaturat ekstreme,
- kushtet e paparashikueshme të motit
- shirat e dendura, stuhitë e borës.



“

Studimi më i fundit i Këshillit të Drejtave të Njeriut (2019 Ndryshimet klimatike dhe varfëria) tregon se situata me ndikimet negative të ndryshimeve klimatike është shqetësuese

- Për shkak të rritjes së temperaturave; pesë vitet e fundit janë më të nxehta në historinë e matjeve moderne;
- Emetimet e dioksidit të karbonit po rriten dhe konsumi global i energjisë parashikohet të rritet me 28% midis viteve 2015 dhe 2040, duke çuar në të ashtuquajturat “përmbytje me probabilitet përsëritjeje një herë në 1000 vjet” dhe uragane shkatërruese;
- nga ana tjetër, miliona njerëz në botë përballen me kequshqyerjen për shkak të thatësirës, gjë që çon në zgjedhje të detyruar: migrim ose uri.

Brenda një afati të shkurtër ose të gjatë, këto pasoja do të shkaktojnë: pasigurinë e burimeve të të ardhurave/jetesës, humbje njerëzore dhe materiale, kufizime të burimeve natyrore, mungesë uji dhe energjie, dëme në infrastrukturë (hidrocentrale të vogla, banesa, rrugë), ndryshime në biodiversitet, pasoja për shëndetin e njeriut, migrim, humbje të tokës bujqësore, humbje të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Në rastet kur disponueshmëria e burimeve natyrore, si druri, peshku dhe burime natyrore themelore, reduktohet si pasojë e ndikimit të drejtpërdrejtë të ndryshimeve klimatike, mundësitë për të fituar për familjet janë të kufizuara. Kjo shpesh çon drejt emigracionit të detyruar për qëllime pune (për burrat) dhe rritjes së përgjegjësive të grave në shtëpitë (për të siguruar ushqim dhe ujë për fëmijët dhe të moshuarit, për t'u kujdesur për nevojat e tyre etj.).

“Gratë preken në mënyrë disproporcionale nga ndikimet e ndryshimeve klimatike si thatësitat, përmytjet dhe ngjarje të tjera ekstreme të motit. Gjithashtu, ato kanë një rol kritik në luftën kundër ndryshimeve klimatike, por duhet të përfaqësohen më mirë në të gjitha nivelet në procesin e vendimmarrjes. Fuqizimi i grave do të jetë faktor i rëndësishëm në përballjen me sfidën klimatike.”

Ish Sekretarja Ekzekutive e UNFCCC, Christiana Figueres



Komunitetet e marginalizuara, veçanërisht gratë e mbyllura në shtëpi që kujdesen për anëtarët më pak të lëvizshëm të familjes, kanë më shumë gjasa të vuajnë dhe të vdesin nga efektet e fatkeqësive të lidhura me klimën, duke përfshirë stuhitë dhe përmytjet. Statusi i ulët socio-ekonomik, shtëpitë e pasigurta dhe kushtet mjedisore i bëjnë gratë të jenë më vulnerabel ndaj përmytjeve

Në fushat bujqësore, ngjarjet ekstreme të nxehtësisë dhe temperaturat e larta mund të shkaktojnë dehidratim të tepruar, dhimbje koke, sëmundje të veshkave dhe goditje nga nxehtësia të punëtorëve të ekspozuar, të cilët janë kryesisht gra.



Në Afrikën Qendrore, ku deri në 90% e liqenit Çad është zhdukur, grupet nomade indigjene janë veçanërisht të rrezikuara. Ndërsa vija bregdetare e liqenit zvogëlohet, gratë duhet të ecin shumë më tej në distanca më të largëta për të mbledhur ujë. Gjatë sezonit të thatë, burrat shkojnë në qytete... duke i lënë gratë të kujdesen për komunitetin,” shpjegon Hindou Oumarou Ibrahim, koordinator i Shoqatës së Grave Indigjene dhe Popullit të Çadit (AFPAT).


Me stinët e thata që po bëhen edhe më të gjata, gratë po punojnë më shumë për të ushqyer dhe për t'u kujdesur për familjet e tyre pa mbështetje. (<https://www.bbc.com/news/science-environment>)



Normat e vdekshmërisë nga fatkeqësitë janë më të larta për gratë sesa për burrat, gjë që mund të jetë gjithashtu për shkak të dallimeve të përcaktuara nga shoqëria në cenueshmërinë e burrave dhe grave. Pas cunamit aziatik të vitit 2004, Oxfam zbuloi se në disa fshatra në Indonezi dhe disa pjesë të Indisë, gratë përbënin mbi 70% të viktimave. Cikloni i vitit 1991 vrau 140 000 persona në Bangladesh, ku 90% e tyre ishin gra dhe vajza të reja (Oxfam, 2010).

Në rolet e tyre tradicionale, gratë në Bosnjë dhe Hercegovinë kanë ndikim të madh në menaxhimin dhe furnizimin e burimeve natyrore në shtëpi dhe në komunitetet, dhe shpesh jetët e grave preken më shumë përmes reduktimit të burimeve jetike (energji, ujë, produkte bujqësore, ndryshime në prodhim dhe tregti). Në disa zona, si rajonet e minierave të qymyrit ku tradicionalisht punojnë burrat, ristrukturimi i kryer për qëllime të lidhura me klimën mund të ketë gjithashtu ndikim negativ specifik gjinor edhe për burrat.

Burimi: Strategjia për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe për zhvillimin me emetime të ulta për Bosnjën dhe Hercegovinën (Qershor 2013)



1.4 Gjinia dhe ndryshimet klimatike

Faktorët që ndikojnë në vulnerabilitetin ndaj ndryshimeve klimatike

Nevoja për të lehtësuar dhe për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike dhe për të luftuar kundër degradimit dhe përdorimit të papërshtatshëm të ekosistemeve dhe biodiversitetit përkatës janë dy sfidat më të mëdha mjedisore të shekullit të 21 dhe kanë lidhje të ngushtë me mirëqenien njerëzore dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Ndikimet e ndryshimeve klimatike ndikojnë ndryshe tek gratë dhe vajzat, burrat dhe djemtë në çdo shoqëri për shkak të klasës socio-ekonomike dhe karakteristikave demografike të tjera të ndërthura, si mosha dhe vendndodhje. Avancimi i barazisë¹ gjinore në kontekstin e krizës klimatike² dhe reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë është një nga sfidat më të mëdha globale

¹ Organizata Botërore e Shëndetësisë përcakton ndryshimin midis seksit dhe gjinisë siç vijon:

Seksi i referohet "ndryshimeve biologjike dhe fiziologjike të karakteristikave të mashkullit dhe femrës, si organet riprodhuese, kromozomet, hormone etj."

Gjinia i referohet karakteristikave të ndërtuara shoqërore të grave dhe burrave - si normat, rolet dhe marrëdhëniet e grupeve të grave dhe burrave dhe marrëdhëniet mes tyre. Ajo varion nga shoqëria në shoqëri dhe mund të ndryshohet. Koncepti i gjinisë përfshin pesë elemente të rëndësishme: relacionale, hierarkike, historike, kontekstuale dhe institucionale. Ndërsa shumica e njerëzve lindin ose mashkull ose femër, atyre u mësohen normat dhe sjelljet e përshtatshme - përfshirë mësimet se si duhet të ndërveprojnë me persona të tjerë të së njëjtës gjini ose të gjinisë së kundërt brenda familjeve, komuniteteve dhe vendeve të punës. Kur individët ose grupet nuk "përputhen" me normat e përcaktuara të gjinisë, shpesh ballafaqohen me stigma, praktika diskriminuese ose përjashtime shoqërore - të gjitha kanë ndikim negativ në shëndet."

² Dita Nderkombetare e Grave 2022: "Barazia e gjinore sot për një të ardhme të qëndrueshme" | UN Women - Selia

të shekullit të 21-të. Çështjet e ndryshimeve klimatike dhe qëndrueshmërisë kanë pasur dhe do të vazhdojnë të kenë ndikime të rënda dhe afatgjata në mjedisin tonë, zhvillimin ekonomik dhe atë shoqëror. Ata që kujdesen për më të pambrojturit dhe më të marginalizuarit përjetojnë ndikimet më të thella. Gruaja po njihet gjithnjë e më shumë si më e prekshme nga ndikimet e ndryshimeve klimatike në krahasim me burrat, pasi gratë përbëjnë pjesën më të madhe të të varfërve të botës dhe janë më të varura nga burimet natyrore që ndryshimet klimatike i kërcënojnë më shumë.

Lidhja midis ndryshimeve klimatike dhe gjinisë është komplekse dhe dinamike, dhe varet si nga organizimi i kontekstit shoqëror dhe nga zhvillimi ekonomik i shtetit. Marrëdhënia nuk është vetëm për vulnerabilitetin ndaj ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike, por edhe për përshtatjen ndaj këtyre ndikimeve, si dhe për gjetjen e mënyrave për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë që shkaktojnë ndryshimet klimatike.

Ndryshimet mund të jenë të ndryshme në varësi të natyrës, ndryshueshmërisë, forcës, shpejtësisë së ndodhjes, ndjeshmërisë së zonës, vendndodhjes etj. por të gjitha kanë një konstante të përbashkët -njerëzit e varfër, të marginalizuar dhe vulnerabel janë grupet më të prekura në shoqëri nga të gjitha llojet e ndryshimeve klimatike. **Gratë dhe burrat i perceptojnë ndryshe pasojat e ndryshimeve klimatike.**

Faktorët që ndikojnë vulnerabilitetin dhe mënyrën e trajtimit të ndryshimeve klimatike si individë janë kryesisht:

- **Biologjikë** - moshë, gjinia, aftësia e kufizuar, shëndeti;
- **Territorialë ose fizikë** - popullsia rurale është më e varfër dhe më e prekshme në krahasim me popullsinë në qendrat urbane;
- **Ekonomikë** - të varfrit janë më të ekspozuar ndaj rreziqeve, sepse kanë më pak burime dhe më pak mundësi për të investuar në teknologji të reja;
- **Socialë** - stilet e jetë në familje, diskriminimi, disponueshmëria e arsimit, e shërbimeve shëndetësore, kushtet e higjienës etj.;
- **Aftësitë dhe informacioni** - mundësia për të mësuar notin, t'i japësh biçikletës ose makinës, mënyrat dhe mundësitë për t'u informuar, trajnimi për ndihmën e parë, trajnimi për efikasitetin e energjisë, etj.;
- **Aktiviteti politik** - pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes dhe përfshirja aktive në planifikim, veprim dhe në vendimet lidhur me ndryshimet klimatike, pushtetin politik dhe përfshirjen shoqërore.

Sipas të dhënave të marra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në vitin 2018 rreth 86% e popullsisë së Kosovës furnizohej me ujë përmes sistemit publik të menaxhuar nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit, ndërsa 14% e popullsisë nuk kishte qasje në shërbimin publik të furnizimit me ujë.

Në Gjilan, në vitin 2021, banorët u lënë pa ujë si rezultat i uljes së niveleve të ujit në Liqenin e Perlepnicsës. Banorët më parë kishin përdorur ujin e rrjetit, por si rezultat i mungesës së tij, u detyruan ta blinin në shishe. Banorët shpesh janë detyruar të furnizohen me ujë nga disa puse në fshatin Pasjan dhe në kampin Monteith. Gjatë dimrit, ata janë të detyruar ta ngrohin ujin dhe ta ruajnë atë. **Zakonisht, këto detyra i bëjnë gratë.**



Kuptimi i rreziqeve dhe i ndikimeve të ndryshmeve klimatike të ndryshme në gra dhe burra është i domosdoshëm për t'i adresuar dhe për të arritur zhvillim të qëndrueshëm. Për ta bërë këtë, duhet të identifikohen nevojat dhe interesat e ndryshme të tyre, dhe duhet të nxitet kontributi i grave dhe i burrave në zhvillimin e zgjidhjeve. Qëndrimi përfshirës do të çojë në rezultate më efektive dhe të qëndrueshme. Për të garantuar zbatim e përgjegjshëm gjinor të agjendës kombëtare klimatike, vendet duhet të sigurojnë që barazia gjinore të konsiderohet sistematikisht dhe në mënyrë reciproke përforcuese. Duhet të merret në konsideratë perspektiva gjinore kur zhvillohen strategjitë për mobilizimin e burimeve, kur zbatohen instrumentet financiare klimatike dhe kur sigurohet pjesëmarrja e barabartë në shfrytëzimin e burimeve financiare, veçanërisht në nivelin lokal³.

Pabarazia gjinore e shkaktuar nga rolet gjinore, diskriminimi dhe normat kulturore rrisin efektet negative të ndryshimeve klimatike në gra dhe vajza. Përrjashtimi i vazhdueshëm, aksesit i barabartë në tokë, asetet ujore dhe prodhuese, dhe pjesëmarrja e pabarabartë në proceset e vendimmarrjes vazhdojnë t'i kufizojnë gratë dhe burrat nga pjesëmarrja e barabartë, kontributi dhe përfitimi nga projekte dhe programe për lehtësimin dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Integrimi i barazisë gjinore në të gjitha nivelet e veprimeve klimatike, nga zhvillimi i politikave klimatike deri te mobilizimi dhe shpërndarja e burimeve financiare klimatike, përfshirë projektimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve, është i rëndësishëm për rezultate përfshirëse që marrin parasysh mënyrën se si ndikojnë ndryshimet klimatike në grupet e ndryshme - dhe në veçanti barrën e padëshirueshme për gra dhe të rinj, për shkak të pabarazive sociale ekzistuese. Përfshirja e konsideratave në projektet e ndryshimeve klimatike, në politika dhe në planifikimin e masave për lehtësimin ose përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor mund të ndihmojë në arritjen e avantazheve të përparimit të barazisë gjinore, në garantimin e efikasitetit dhe në kthimet më të mëdha të investimeve në veprimet klimatike.

3 Gjinia dhe Financimi i Ndryshimeve Klimatike | UNFCCC



1.5 Masat për lehtësimin ose përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike

Masat për lehtësimin dhe reduktimin e ndikimeve

Lehtësimi/parandalimi ose “lehtësimi” i ndryshimeve klimatike përfshin kryesisht uljen ose parandalimin e emetimeve të gazeve serrë dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Kjo nënkupton përdorimin e teknologjive të reja dhe të burimeve të rinovueshme të energjisë, përdorimin e pajisjeve më efikase në përdorimin e energjisë ose ndryshim në menaxhimin dhe përdorimin e energjisë.

Masat mund të jenë komplekse: nga planifikimi urban i qyteteve të tëra, deri te ndërhyrjet e vogla si zëvendësimi i sobave, zëvendësimi i një mjeti me një mjet me emetime më të ulëta të CO₂, menaxhimi i mëtejshëm i mbeturinave, zhvillimi i qëndrueshëm në bujqësi dhe blegtori, deri tek krijimi i më shumë korsive të biçikletave dhe rrugëve për këmbësorët..

Masat për të lehtësuar ndikimet e ndryshimeve klimatike në sektorin e energjisë::



- Rinovimi i ndërtesave për t'i bërë ato më efikase në energji;
- Adoptimi i burimeve të rinovueshme të energjisë si dielli, era dhe hidrocentralet e vogla;
- Ndhurma në zhvillimin e qyteteve me transport më të qëndrueshëm si transporti i shpejtë i autobusëve, automjetet elektrike dhe biokarburantet; dhe
- Promovimi i përdorimit më të qëndrueshëm të tokës dhe pyjeve.

Promovimi i inovacionit dhe transferimit të teknologjisë për energji të qëndrueshme. Teknologjia është një nga çelësat për uljen ose ngadalësimin e rritjes së emetimeve të gazeve serrë dhe për stabilizimin e tyre, duke u fokusuar tek:

- energjia e rinovueshme e decentralizuar me ruajtje të energjisë;
- teknologjitë e drejtuara nga energjia elektrike dhe mobiliteti elektrik;
- shpejtimi i pranimit të efikasitetit të energjisë dhe,
- inovacioni i teknologjive të pastra.



Veprimet për të lehtësuar ndikimet e ndryshimeve klimatike⁴ kanë potencialin të sjellin gjithashtu ndikime pozitive lokale në lidhje me gjininë. Kjo mund të arrihet përmes natyrës së përgjithshme të një projekti apo programi lehtësimi, si energjia e pastër për ndriçimin ose gatimin në shtëpi, ose duke marrë në konsideratë specifikisht ndikimet e barabarta të gjinisë që herët në fazën e planifikimit të projektit, për shembull duke konsideruar ku do të shkojnë të ardhurat në mënyrë që të kenë ndikime potenciale pozitive në jetën e grave duke përmirësuar jetën dhe shëndetin dhe duke u mundësuar kohë për ndjekjen e mundësive shtesë.

Masat për përshtatjen ndaj ndryshimeve të ndryshimeve klimatike

“Përshtatja” ndaj ndryshimeve klimatike është procesi i përshtatjes ndaj ndryshimeve të klimës reale ose të pritshme dhe ndaj efekteve të tyre. Përmes përshtatjes, synohet zvogëlimi ose shmangia e dëmeve, pra, gjetja e mënyrave për të përfituar nga mundësitë ekzistuese. Në disa sisteme natyrale, ndërhyrja njerëzore mund të lehtësojë përshtatjen ndaj klimës së pritshme dhe ndaj efekteve të saj.” (Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike - IPCC).

Si shembull të përshtatjes parashikuese mund të përmendim një fermer që vendos të mbjellë kultura që kërkojnë më pak ujë, duke e ditur se klima në të ardhmen do të bëhet më e thatë.

Si shembull të përshtatjes së planifikuar mund të përmendim ndryshimet në rregulloret e ndërtimit, me qëllim që ndërtesat e reja të jenë të qëndrueshme në një klimë më të ngrohtë.



Masat për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e bujqësisë:

- Përmirësimi i sistemeve të ujitjes, duke përfshirë përdorimin e një sistemi qendror për mbikëqyrje dhe kontrolli, si dhe menaxhimin e burimeve (për të kursyer si ujin, ashtu dhe energjinë elektrike).
- Diversifikimi i burimeve ujore, duke përfshirë kombinimin e nxjerrjes së ujit nga sipërfaqja dhe nga nëntoka.
- Pastrimi i kanaleve vaditëse për të parandaluar përmytjet e mundshme.

Masat për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e shëndetësisë:

- Vendosja e bimëve të gjelbra në çati dhe në muret e jashtme të ndërtesave për të ulur temperaturën e vetë ndërtesës dhe për të parandaluar emetimin e ngrohtësisë.
- Mbjellja e pemëve në rrugë për të ulur temperaturën e rrugëve.

Masat për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e trashëgimisë kulturore:

- Mbjellja e pemëve pranë vendbanimeve arkeologjike ekzistuese për të parandaluar erozionin e tokës dhe vijimësinë e rrëshqitjeve dhe përmytjeve.

Një masë përshtatjeje me ndjeshmëri gjinore do të ishte investimi dhe ofrimi i korsive të biçikletave, konsultimi me gratë dhe burrat që i përdorin ato për të diskutuar nevojat, problemet dhe organizimin e nevojshëm të korsive. Gjithashtu, një masë tjetër është përmirësimi i transportit publik përmes zgjerimit të rrjetit, blerjes së autobusëve të rinj ekologjikë etj.

Për rritjen e efikasitetit të energjisë të ndërtesave, si masë neutrale në raport me gjininë mund të përmendim, për shembull, trajnimin e administratorëve të ndërtesave të banimit mbi efikasitetin e energjisë, ndërsa si masë me ndjeshmëri gjinore dhe motivuese do të përmendim

trajnimin e banorëve, me qëllim përfshirjen e tyre dhe kuptimin e avantazheve të efikasitetit të energjisë, si dhe i mënyrave të kontributit të tyre në përmirësimin e funksionimit të ndërtesës së banimit, ku përfshihen edhe gratë

Integrimi i pikëpamjeve gjinore në përshtatjen afatmesme dhe afatgjatë ndaj ndryshimeve klimatike⁵ mund të ndihmojë në garantimin e efikasitetit dhe zbatueshmërisë së përshtatjes në terren. Ky integrim mund të ndihmojë në garantimin e mospërkeqësimit të pabarazive dhe vulnerabiliteteve nga zbatimi i veprimtarive të përshtatjes, në përmbushjen e nevojave specifike të individëve më vulnerabël, të sigurojë pjesëmarrjen e barabartë të burrave dhe grave në fazat e vendimmarrjes dhe në zbatimin e këtyre veprimtareve.



02

Kuadri Ndërkombëtare për Ndryshimet Klimatike



2.1 Integrimi gjinor në Kuadrin Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike

Ndryshimet klimatike janë një nga kërcënimet më të mëdha për të drejtat e njeriut të brezit tonë dhe paraqesin rrezik serioz për të drejtat themelore të jetës, shëndetit, ushqimit dhe për një nivel të përshtatshëm jetesë të individëve dhe komuniteteve në botë. Njerëzit në të gjithë botën po përjetojnë efektet negative të ekosistemeve në rënie për shkak të degradimit mjedisor, përfshirë mungesën e ujit, shterjen e burimeve natyrore, katastrofat natyrore për shkak të shpyllëzimit, si dhe menaxhimin dhe asgjësimin e pasigurt të produkteve dhe mbetjeve toksike e të rrezikshme. Këto faktet tregojnë qartazi lidhjet e ngushta mes mjedisit dhe gëzimit të të drejtave të njeriut dhe justifikojnë qasjen e integruar ndaj mjedisit dhe ndaj të drejtave të njeriut.

Barazia gjinore është një nga të drejtat themelore të njeriut që përfshihet në një sërë deklaratash dhe konventash ligjërish të vlefshme, përfshirë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW-1979). CEDAW shpesh konsiderohet si karta ndërkombëtare e të drejtave të grave dhe është themelore për avancimin e barazisë gjinore. Qeveritë nënshkruese janë të detyruara të veprojnë për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e grave; ato bien dakord të përfshijnë parimin e barazisë në legjislacion dhe të sigurojnë që ai të funksionalizohet në të gjithë vendin e tyre. Në Nenin 14, vëmendje e veçantë i kushtohet diskriminimit të grave në zonat rurale, me qëllim garantimin e aksesit dhe përfitimeve të tyre.

(Lexo më shumë në: <https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/cedaw>)



Deklarata e Stokholmit, dhe, pak më pak, ajo e Rios, tregojnë se si lidhja midis të drejtave të njeriut, dinjitetit dhe mjedisit ishte në thelb të vëmendjes së përpjekjeve të hershme të Kombeve të Bashkuara për të adresuar problemet mjedisore. Parimi i 20-të i **Deklaratës së Rio për Mjedisin dhe Zhvillimin (1992)** thotë se: "Gratë kanë rol themelor në menaxhimin dhe zhvillimin e mjedisit. Prandaj, pjesëmarrja e tyre e plotë është e domosdoshme për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.




Po ashtu, është edhe **Konventa për Biodiversitetin Biologjik (1992)**, e cila promovon njohuritë dhe praktikën e grave në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të diversitetit biologjik në sektorin bujqësor. Kjo konventë promovon mënyra, specifike për gjininë, për dokumentimin dhe ruajtjen e njohurive të grave për biodiversitetin. Ajo bën thirrje për ekuilibër gjinor në organe të ndryshme. Gjithashtu, përmendet edhe ndikimi gjinor dhe kulturor

i turizmit. **Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Shkretëtirëzimit në vende që pësojnë thatësira të rënda dhe/ose shkretëtirëzim (2002)** synon të promovojë ndërmarrjen e veprimeve efektive përmes programeve lokale inovative dhe mbështetjes nga partneritetet ndërkombëtare. Marrëveshja pranon luftën e gjatë të mbrojtjes së tokave të thata dhe mungesën e pritshmërive për rezultatet të shpejta, pasi shkaqet e shkretëtirëzimit të tokës janë të shumta dhe komplekse, përfshirë këtu edhe modelet e tregtisë ndërkombëtare dhe praktikën e paqëndrueshme të menaxhimit të tokës.

Konventa nënvizon rolin e **rëndësishëm të grave** në rajone të prekura nga shkretëtirëzimi i tokës dhe/ose thatësira, sidomos në zonat rurale të vendeve në zhvillim, si dhe rëndësinë e garantimit të pjesëmarrjes së plotë të burrave dhe grave në të gjitha nivelet. Konventa kërkon programe kombëtare veprimi që rrisin pjesëmarrjen e popullatës dhe komuniteteve lokale, përfshirë gratë, fermerët dhe blegtorët, si dhe delegimin e përgjegjësisë më të rënda menaxheriale këtyre grupeve të synuara.

Një nga parakushtet themelore të **Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC)** - 1997 paraqet hartimin dhe zbatimin e politikave për uljen e emetimeve të gazeve serrë si detyrim për të gjitha vendet, sidomos për ato të zhvilluarat që zënë edhe pjesën më të madhe të emetimeve të gazit serrë (Shtetet e Bashkuara, Evropa dhe Japonia). Konventa përcakton detyrimet për vendet nënshkruese, duke marrë në konsideratë përgjegjësitë e tyre të përbashkëta dhe individuale. **Koncepti gjinor** në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (**UNFCCC**) u prezantua për herë të parë në vitin 2005. Ajo e ruajti fokusin tek gjinia dhe ndryshimet klimatike me Marrëveshjen e Parisit, e cila thotë: “Kur palët ndërmarrin veprime për adresimin e ndryshimeve klimatike, ata duhet të respektojnë, të promovojnë dhe të marrin parasysh detyrimet e tyre në lidhje me të drejtat e njeriut, të drejtën për shëndet, popullsinë, komunitetet lokale, emigrantët, fëmijët, personat me nevoja të veçanta dhe njerëzit në situata vulnerabël, të drejtën për zhvillim, si dhe barazinë gjinore, fuqizimin e grave dhe barazinë ndër gjenerata.

Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut njohu kërcënimin e ndryshimeve klimatike në rezolutën e tij 7/23, “Të drejtat e njeriut dhe ndryshimet klimatike” (28 mars 2008) duke shprehur shqetësimin e “paraqitjes së kërcënimeve të menjëhershme dhe në nivele të mëdha për njerëzit dhe komunitetet në të gjithë botën” nga ndryshimet klimatike. Nëpërmjet Rezolutës 64/2921, në vitin 2010 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara konfirmoi konsensusin e rritur se mjedisi është drejtpërdrejt i lidhur me mirëqenien e njeriut dhe me zbatimin e të drejtave të njeriut. Një nga marrëveshjet shumëpalëshe më të rëndësishme në fushën e mjedisit dhe fuqizimit të reagimit global ndaj kërcënimeve të ndryshimeve klimatike është **Marrëveshja e Parisit**, e cila u miratua më 12 dhjetor 2015 në Paris, Francë në Samitin Global për Ndryshimet Klimatike organizuar nga Kombet e Bashkuara. Marrëveshja synon përmirësimin e reagimit global ndaj ndryshimeve klimatike, në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përpjekjeve për çrrënjosjen e varfërisë përmes: vazhdimin të përpjekjeve për kontrollin e rritjes së temperaturës nën 20C, rritjes së aftësive të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në mënyrë të tillë që të mos dëmtohet prodhimi i ushqimit, bashkërendimit të flukseve financiare me mënyrat e arritjes së emetimeve të ulëta të gazeve serrë dhe me zhvillim rezistent ndaj klimës.



Marrëveshja e Parisit e vitit 2015, shënon hapat e zhvillimit e regjimit të OKB-së për ndryshimet klimatike dhe përshkruan rrugën e re të përpjekjeve globale për luftimin e tyre. Ajo njih pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, por gjithashtu kërkon politika transparente, ndërgjegjësimit publik, pjesëmarrje publike dhe akses publik në informacion dhe bashkëpunim. Marrëveshja pranon se ndryshimet klimatike janë shqetësim i përbashkët i të gjithë njerëzimit dhe gjatë ndërmarrjes së veprimeve për adresimin e ndryshimeve klimatike, palët duhet të respektojnë, të promovojnë dhe të konsiderojnë detyrimet e tyre në lidhje me të drejtat e njeriut, të drejtën për shëndet, të drejtën për zhvillim, të drejtat e popujve autoktonë, të komuniteteve lokale, emigrantëve, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe të njerëzve në situata vulnerabël, si dhe barazinë gjinore, fuqizimin e grave dhe drejtësinë ndër brezave.

Rezoluta 48/13 e OKB-së⁶ (që nga tetori i vitit 2021) **për të Drejtën për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm** "Pranohet gjithashtu se, ndërsa pasojat për të drejtat e njeriut të dëmtuara nga dëmi mjedisor ndihen nga individët dhe komunitetet në mbarë botën, ato ndihen më intensivisht nga segmentet e popullsisë që janë tashmë në situata vulnerabël, duke përfshirë popujt indigjenë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë e vajzat. Këshilli për të Drejtat e Njeriut: "4. Nxit shtetet: (a) Të ndërtojnë kapacitetet e përpjekjeve për mbrojtjen e mjedisit në mënyrë që të përmbushin detyrimet dhe angazhimet e tyre për të drejtat e njeriut, dhe të rrisin bashkëpunimin me shtetet e tjera, Zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, me sistemet e tjera të Kombeve të Bashkuara dhe organizatat ndërkombëtare e rajonale, agjencitë, sekretariatet e konventave dhe programuesit, dhe palët përkatëse jo-shtetërore të interesit, duke përfshirë shoqërinë civile, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe biznesin, për zbatimin e së drejtës për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, në përputhje me mandatet e tyre përkatëse;

Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike e vitit 2022 ose Konferenca e Palëve të UNFCCC, shpesh e quajtur si COP27, ishte konferenca e 27-të e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, e mbajtur më 6 - 20 nëntor 2022 në Sharm El Sheikh, Egjipt. Ajo u zhvillua nën presidencën e Ministrit të Jashtëm egjiptian Sameh Shoukry, me më shumë se 92 krerë shtetesh dhe rreth 35 000 përfaqësues ose delegatë të 190 vendeve pjesëmarrëse. Në konferencë, u ra dakord, për herë të parë, për një fond humbjesh dhe dëmsh. Fondi i humbjeve dhe dëmeve është marrëveshja për sigurimin e fondeve për vendet më vulnerabël dhe më të prekura nga ndryshimet klimatike.

Marrëveshja e Gjelbër Evropiane, e miratuar në vitin 2020, është një grup politikash të hartuara nga Komisioni Evropian me qëllim kryesor neutralitetin e Evropës ndaj klimës deri në vitin 2050. Ajo është një paketë ambicioze masash që variojnë nga ulja ambicioze e emetimeve të gazeve

6 Akthesi në mjedis të shëndetshëm, i shpallur si e drejta e njeriut nga këshilli i OKB-së për të drejtat e njeriut | Lajmet e OKB-së



serrë, tek investimi i kërkim-studimeve dhe i inovacioneve më të avancuara, deri te ruajtja e mjedisit natyror të Evropës. Iniciativat e para të veprimit për klimën në kuadër të Marrëveshjes së Gjelbër përfshijnë::

- **Ligjin Evropian të Klimës** për përfshirjen e objektivit të neutralitetit të klimës deri në vitin 2050 në Legjislacionin e BE-së
- **Paktin Evropian të Klimës** për të angazhimin e qytetarëve dhe të të gjitha pjesëve të shoqërisë në veprimet klimatike
- **Planin e Objektivave Klimatike 2030** për uljen e mëtejshme të emetimeve neto të gazeve serrë me të paktën 55% deri në vitin 2030.
- **Strategjinë e re të BE-së** për përshtatjen klimatike me qëllim bërjen e Evropës një shoqëri të qëndrueshme ndaj klimës deri në vitin 2050 dhe të përshtatur plotësisht me ndikimet e pashmangshme të ndryshimeve klimatike.

E drejta për një mjedis ekologjikisht të pastër garantohet nga mbi 100 kushtetuta në mbarë botën – ajo përkufizohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin si “çfarëdolloj shpalljeje e së drejtës së njeriut për kushte mjedisore të një cilësie të caktuar”. Sipas përkufizimit të Programit, të drejtat mjedisore mund të jenë thelbësore dhe procedurale. Ndërsa të drejtat thelbësore i referohen mundësisë së mbrojtjes nga pasojat që ka degradimi i mjedisit mbi të drejtat civile dhe politike, të drejtat për jetën dhe lirinë e shprehjes, të drejtat kulturore dhe sociale, si e drejta për shëndet, ujë, ushqim dhe kulturë, të drejtat procedurale janë kushtet paraprak i domosdoshëm për zbatimin e të drejtave të grupit të parë. Ato përfaqësojnë pikën e takimit të ligjit për mjedisin dhe ligjit për të drejtat e njeriut – këto të drejta parashikojnë hapat formalë që duhet të ndërmerren në procesin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Të drejtat procedurale përfshijnë të drejtën për kërkimin e pëlqimit paraprak të mirinformuar nga qytetarët, për aksesin në informacion, pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe aksesin në drejtësi.

Normat ndërkombëtare dhe ato rajonale janë plotësuese dhe kërkojnë zbatim efektiv kombëtar. Për rrjedhojë, normat kombëtare duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rajonale. Mekanizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë ofrojnë mbrojtje ligjore pas ezaurimit të të gjitha zgjidhjeve ligjore/mundësive kombëtare.

Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm - Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të, 2030)

Axhenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, me 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të), 169 qëllimet dhe 232 indikatorët për gjurmimin e ecurisë së njerëzimit drejt mirëqenies themelore të të gjithëve, pasqyron një konsensus politik global për zhdukjen e varfërisë dhe për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel global.

Axhenda 2030 balancon dimensionet ekonomike, sociale dhe mjedisore të zhvillimit të qëndrueshëm dhe bën thirrje për një qasje holistike. Gjatë planifikimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve, vëmendje duhet t'i kushtohet ndërlidhjeve dhe veprimeve të integruara që mund të krijojnë përfitime të përbashkëta dhe që përmbushin objektivat e shumëfishta në mënyrë koherente. Ndërhyrjet duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të adresojnë njëkohësisht disa OZHQ që për të rritur ndikimin dhe efikasitetin e burimeve të përdorura. Kjo është gjithashtu e rëndësishme për raportimin e BE-së mbi kontributin e tij në zbatimin e OZHQ-ve.

Parimi “Të mos lëmë askënd pas” LNOB është një nga zotimet kryesore të Axhendës 2030 (rikonfirmuar në Konsensusin Evropian për Zhvillim 2017). Ky parim na sjell ndërmend se ndërhyrjet tona zhvillimore synojnë çrrënjosjen e varfërisë në të gjitha format e saj, reduktimin

e vulnerabiliteteve dhe adresimin e pabarazive për promovimin e mundësive të barabarta për të gjithë (me shumë informacion: Transformimi i botës sonë: Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm).

OZHQ-të⁷ janë grupuar në pesë kategori kryesore: Njerëzit, Planeti, Prosperiteti, Paqja dhe Partneriteti. Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave (OZHQ 5) është synim më vete në kategorinë "Njerëzit". Kushtet legislative për barazinë gjinore referohen në kategoritë "Paqja", "Njerëzit" dhe "Prosperiteti" (OZHQ 16, OZHQ 1 deri 4 dhe OZHQ 7 deri 11 përkatësisht). Fuqizimi i grave dhe vajzave është referuar në pesë synimet e kategorisë "Planeti" dhe në qëllimet dhe treguesit e tyre (OZHQ 6 dhe OZHQ-të 12 deri 15), të cilat lidhen drejtpërdrejt me mjedisin.

Sa i përket qëndrueshmërisë mjedisore, pesë qëllimet e kategorisë "Planeti" janë: OZHQ 6 (Ujë i pastër dhe kanalizime), OZHQ 12 (Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm), OZHQ 13 (Ndryshimet klimatike), OZHQ 14 (Jeta nën ujë) dhe OZHQ 15 (Jeta në tokë). Po ashtu, mjedisi është aspekt i rëndësishëm i tre qëllimeve të kategorisë "Prosperiteti": OZHQ 7 (Energji e përbalueshme dhe e pastër), OZHQ 9 (Industri, inovacion dhe infrastrukturë) dhe OZHQ 11 (Qytete dhe komunitete të qëndrueshme). Gjithashtu, promovimi i bujqësisë së qëndrueshme është pjesë e OZHQ 2 (Zero uri). Për rrjedhojë, janë gjithsej nëntë qëllime të OZHQ-ve që lidhen me mjedisin.

Si barazia gjinore, ashtu edhe qëndrueshmëria mjedisore luajnë rol të rëndësishëm në Axhendën 2030. Vetëm 20 tregues unikë (nga 231 gjithsej) nga të gjitha OZHQ-të përfshijnë si gjininë, ashtu edhe mjedisin. Axhenda 2030 qartëson përgjegjësitë e të gjitha shteteve për të respektuar, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut pa asnjë lloj dallimi. Axhenda 2030 nuk është në vetvete detyruese, por është mjet për avancimin shtytës të detyrimeve të drejtave të njeriut. Axhenda 2030 duhet të zbatohet në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me detyrimet e shteteve sipas legjislacionit ndërkombëtar.

2.2 Axhenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor

Standardet e Axhendës së Gjellbër të BE-së snë lidhje me sfidat mjedisore dhe ato klimatike u miratuan nga Ballkani Perëndimor në Samitin e Sofjes 2020 në formatin e **Axhendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor**, e cila është reflektim, zgjerim dhe përshtatje e Axhendës së Gjellbër të BE-së e për rajonin. Plani i Veprimit përfshin 58 veprime dhe 7 udhërrëfyes për zbatim në lidhje me temat e politikave klimatike, energjinë e qëndrueshme, mobilitetin e qëndrueshëm, ekonominë qarkulluese, pastrimin nga ndotja, bujqësinë e qëndrueshme dhe furnizimin me ushqim dhe mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit.

Ndër të tjera, Plani parashikon miratimin e objektivave të Politikës së Energjisë dhe Klimës 2030 për përfshirjen e çmimit të karbonit, planet për heqjen e qymyrit, kontrollin e ndotjes, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, integrimin rajonal dhe kuadrin kohor tregues për harmonizimin me Sistemin e Tregtimit të Emetimeve të Bashkimit Evropian nga viti 2024.

Axhenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor është një strategji e re rritjeje për rajonin, duke kapërcyer nga një model ekonomik tradicional në një ekonomi të qëndrueshme, në përputhje me Axhendën e Gjellbër Evropiane.

7 1. Barazia gjinore dhe zhvillimi i qëndrueshëm | Gjinia dhe Mjedisi: Krijimi i provave dhe hartimi i politikave për përmbushjen e OZHQ-ve | iLibrary OECD (oecd-ilibrary.org)

Ajo është përfshirë në Planin Ekonomik dhe në atë të Investimeve, i cili ka potencial vërtet transformues dhe synon të nxisë rimëkëmbjen afatgjatë të Ballkanit Perëndimor dhe bashkërendimin e tij ekonomik me BE-në.

2.3 Angazhimi i palëve të interesit, informacioni dhe pjesëmarrja e publikut në procesin e planifikimit të ndryshimeve klimatike

Kriteret kryesore ligjore të përfshirjes së palëve të interesit, në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar, përcaktohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara tashmë nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe nga Direktivat e Bashkimit Evropian që janë transpozuar ose po transpozohen në legjislacionet kombëtare.

Konventa e Aarhusit (Konventa për pjesëmarrjen e publikut) është dokumenti i parë ndërkombëtar që i mundëson publikut akses të drejtpërdrejtë në informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe akses të përmirësuar në çështjet e drejtësisë që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Tre shtyllat e Konventës së Aarhusit janë:

- # 1 Garantimi i aksesit publik në informacionet mjedisore të ofruara nga autoritetet publike;
- # 2 E drejta e publikut për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse për mjedisin;
- # 3 Akses në drejtësi për çështjet mjedisore.



Direktivat e BE-së për informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në procesin e vendimmarrjes (si hartimi i dokumenteve të planifikimit strategjik për veprimet klimatike) janë:



Aksesi në Direktivën për qasjen publike në informacionin mjedisor (2003/4/KE)

qëllimi i kësaj directive është të garantojë lirinë e aksesit dhe shpërndarjen e informacionit të zotëruar nga autoritetet publike. Përkufizimet e “autoritetit publik” dhe “informacionit mjedisor” shtjellohen më dhe përkufizohen më qartë. Në përgjithësi, informacioni duhet të vihet në dispozicion brenda një muaji nga kërkesa. Direktiva zbaton edhe një pjesë të Konventës së Aarhusit.

Pjesëmarrja e publikut sa i përket hartimit të planeve dhe programeve të caktuara dhe aksesit në Direktivën për drejtësi (2003/35/KE)

është instrumenti ligjor kryesor për përafrimin e legjislacionit të Komunitetit me dispozitat e Konventës së Aarhusit. Ajo përditëson dispozitat për pjesëmarrjen e publikut në procedurat e dhënies së lejeve në nivel kombëtar në bazë të legjislacionit për çështjet mjedisore dhe klimatike, si dhe paraqet rregullat për aksesin në drejtësi.



Kontributet Kombëtare të Pikësnyuara janë pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Parisit dhe shërbejnë për arritjen e qëllimeve të saj sa i përket rritjes së veprimeve klimatike dhe zhvillimit të gjelbër dhe të qëndrueshëm ndaj klimës. Procesi i UNFCCC ka nxjerrë në pah nevojën për veprim të drejtuar nga palë të shumta interesi për klimën, në të gjitha nivelet e aktiviteteve që lidhen me të gjitha grupet e KKP-ve dhe me proceset e planit kombëtar të përshtatjes. Angazhimi i OSHC-ve mund të jetë vendimtar për advokimin e ambicieve më të larta dhe për përforcimin e zërave të asaj pjese popullsie më vulnerabël, më të varfër ose të marginalizuar. Sipas Kontributeve Kombëtare të Pikësnyuara, sektorët prioritarë për zbatimin e masave për zbutjen dhe reduktimin ose miratimin e ndikimeve nga ndryshimet klimatike në vendet e Ballkanit Perëndimor (Kosova, Republika e Shqipërisë, Republika e Serbisë, Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republika e të Malit të Zi) janë **bujqësia, pylltaria dhe përdorimet e tjera të tokës, prodhimi dhe aksesit në energji (së bashku me PIPP) dhe siguria e ushqimit dhe ujit.**

Nëpërmjet advokimit, informimit, ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, mbështetjes teknike, kërkimeve, ndërtimit të qëndrueshmërisë dhe krijimit të rrjeteve dhe platformave, OSHC-të mund të kontribuojnë dhe të marrin pjesë në procesin zyrtar, të sjellin vulnerabilitetet e nivelit bazë në procesin e vendimmarrjes, dhe të marrin rolet e tyre si aktorë kryesorë në këtë hapësirë. Ka një sërë boshllëqesh dhe pengesash me të cilat përballen OSHC-të gjatë përfshirjes së aktiviteteve të tyre në procesin kombëtar të rishikimit të KKP-ve. Angazhimi i OSHC-ve mund të lehtësohet në disa mënyra, si për shembull, përmes ndërtimit të kapaciteteve teknike mes OSHC-ve, miratimit të ligjeve ose politikave për angazhimin e palëve të interesit në proceset klimatike, marrjes së masave aktive për angazhim e tyre në vendimmarrje, kryerjes së takimeve të rregullta dhe komunikimeve për shkëmbimin e përditësimeve mbi veprimet klimatike, sigurimin e mbështetjes teknike, koordinueset dhe financiare për OSHC-të, ngritjen e një procesi të pavarur monitorimi dhe vlerësimi për aktivitetet e lidhura me KKP-të dhe adresimin e çështjeve të mbështetjes financiare.

Sipas Kontributeve Kombëtare të Pikësnuara, sektorët prioritarë për zbatimin e masave për zbutjen dhe reduktimin ose miratimin e ndikimeve nga ndryshimet klimatike në vendet e Ballkanit Perëndimor (Kosova, Republika e Shqipërisë, Republika e Serbisë, Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republika e të Malit të Zi) janë bujqësia, pylltaria dhe përdorimet e tjera të tokës, prodhimi dhe aksesimi në energji (së bashku me PIPP) dhe siguria e ushqimit dhe ujit.

Në Shtojcën 1, janë dhënë shembuj të masave të përcaktuara në dokumentet e përditësuara të KKP-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor.

2.4 Korniza e Përmirësuar e Transparencës (KPT) sipas Marrëveshjes së Parisit dhe roli i OSHC-ve

ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (OSHC) janë subjekte vullnetare jo-qeveritare, jofitimprurëse, të themeluara nga njerëz të sferës sociale, të ndarë nga shteti dhe tregu. OSHC-të përfaqësojnë një gamë të gjerë interesash dhe lidhjesh.

Në veprimtaritë e tyre, OSHC-të mund të përfshihen në identifikimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve dhe projekteve të ndryshme, për të ndikuar qeverisjen dhe procesin e vendimmarrjes, mund të bashkëpunojnë me komunitetet dhe të ndërveprojnë me qeveritë në nivel kombëtar dhe lokal. Aktorët e shoqërisë civile shpesh shërbejnë si forca drejtuese në drejtimin e politikave zhvillimore dhe si mbikëqyrës për të siguruar zbatimin e politikave në çdo fushë. Ata janë partnerë të rëndësishëm në të gjitha veprimtaritë kombëtare për zbatimin e Agjendës 2030.

Monitorimi i Perspektivës gjinore për financimin e ndryshimeve klimatike i referohet analizës/vlerësimit gjinor⁸ përmes prizmit të integritit gjinor dhe metodave të përdorura për kuptimin e marrëdhënieve mes burrave dhe grave, aksesin e tyre në burime, aktivitetet e tyre dhe kufizimet me të cilat përballen në raport me njëri-tjetrin. Analiza/vlerësimi gjithëpërfshirës gjinor përfshin shqyrtimin e roleve, të të drejtave, nevojave dhe mundësive të ndryshme të grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në një projekt/program të caktuar ose në kontekstin e një iniciative për ndryshimet klimatike. Këto analiza dhe vlerësime janë mjete që ndihmojnë promovimin e pikave hyrëse përkatëse gjinore, politikave dhe identifikojnë mundësitë për rritjen e barazisë gjinore në një projekt/program të caktuar ose në iniciativa për ndryshimet klimatike. Në OKB⁹, termi Integrimi gjinor përkufizohet si: Procesi i vlerësimit të pasojave për gratë dhe burrat të çdo veprimi të planifikuar, duke përfshirë legjislativonin, politikën apo programet, në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet.

Integrimi gjinor¹⁰ është pranuar ndërkombëtarisht si strategjia drejt arritjes së barazisë gjinore. Ai përfshin integrimin e perspektivës gjinore në përgatitjen, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, masave rregullatore dhe programeve të shpenzimeve, me qëllim promovimin e barazisë mes burrave dhe grave dhe luftën kundër diskriminimit.

⁸ Formulari 9: Modele Analize Gjinore/Vlerësimi dhe Plani Veprimi për Përfshirjen Sociale dhe Gjinore në kuadër të paketës së zbatimit të Fondit të Gjellbër Klimatik

⁹ https://unterm.un.org/unterm/Display/record/UNDP/NA?OriginalId=imp-2015-11-11_14-16-25-144

¹⁰ <https://eige.europa.eu/>

Përmasat e integritit gjinor janë:

- ✓ Prezantimi i barabartë i grave dhe burrave në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave, por edhe si përfitues të politikave të zbatuara
- ✓ Zbatimi i perspektivës gjinore në përmbajtjen e politikave

Pyetjet kryesore për integrimin gjinor janë:

A njihen dhe merren parasysh nevojat e burrave dhe grave



A marrin vendime në nivel të barabartë burrat dhe gratë




A kanë burrat dhe gratë akses të barabartë në burime? Po, kontroll të barabartë të burimeve



A përfitojnë burrat dhe gratë në mënyrë të barabartë nga burimet



Procesi i integritit gjinor ndjek procesin e hartimit të politikave në nivel lokal dhe kombëtar dhe i lë hapësirë OSHC-ve për t'u përfshirë në cilëndo nga fazat:



Iniciativa e përgjigjshme gjinore ose ajo me ndjeshmëri gjinore pasqyron zbatimin e analizës gjinore në projektimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e ndërhyrjes.

Mjetet dhe metodat e integritit gjinor që mund të përdoren në cilëndo fazë janë dhënë në Tabelën 1:

Tabelën 1: Mjetet dhe metodat e integritit gjinor

Mjetet për vlerësimin e nevojave	Mjetet për fazën e planifikimit	Mjetet për fazën e zbatimit	Mjetet për monitorimin dhe vlerësimin e politikave
Statistikat gjinore	Përcaktimi i treguesve gjinorë	Ndërtimi i kapaciteteve për barazinë gjinore	Auditimi gjinor
Analiza gjinore	Planifikimi me ndjeshmëri gjinore i ndërhyrjeve/ politikave	Transformimi me ndjeshmëri gjinore i institucioneve	Monitorimi me ndjeshmëri gjinore
Vlerësimi gjinor	Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor	Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet gjinore	Vlerësimi me ndjeshmëri gjinore
Konsultimi me palët e interesit	Prokurimet publike me ndjeshmëri gjinore		

Analiza gjinore¹¹ është një mjet për diagnostikimin e dallimeve mes grave dhe burrave në lidhje me aktivitetet e tyre specifike, kushtet, nevojat, aksesin dhe kontrollin mbi burimet, si dhe aksesin e tyre tek përfitimet që vijnë nga zhvillimi dhe nga proceset e vendimmarrjes. Analiza studion lidhjet midis tyre dhe mes faktorëve të tjerë në një kontekst më të gjerë socio-kulturor, ekonomik, politik dhe mjedisor. Ka një dallim mes nevojave praktike dhe nevojave e interesave strategjike të grave dhe burrave. Kuptimi i këtij dallimi na ndihmon të identifikojmë masat pozitive që mund të ndërmerren për rregullimin e pabarazive mes grave dhe burrave.

Nevojat praktike janë ato nevoja që mund të konsiderohen si të menjëhershme si për gratë, ashtu edhe për burrat (nevojat bazë si uji, ushqimi, të ardhurat, strehimi dhe kujdesi shëndetësor). Iniciativat që synojnë vetëm përmbushjen e nevojave praktike kërkojnë t'u përgjigjen problemeve që lindin nga kushtet e papërshtatshme të jetesës.

Interesat **strategjike** lidhen me statusin relativ të grave dhe burrave brenda shoqërisë së tyre. Interesat ndryshojnë nga një kontekst në tjetrin dhe lidhen me ndryshimin e pozitës apo statusit të grave përmes adresimit të roleve dhe pritshmërive gjinore, si dhe ndarjes gjinore të punës, burimeve dhe pushtetit. Shembuj të iniciativave për promovimin e interesave strategjike përfshijnë mbrojtjen nga dhuna në familje, zvogëlimin e hendekut të pagave dhe rritjen e mundësive për vendimmarrje nga gratë. Vlerësimi i **aksesit dhe kontrollit mbi burimet dhe përfitimet** na lejon të kuptojmë se cilat burime dhe përfitime shihen si të vlefshme nga komuniteti dhe kush mund të ushtrojë të drejtën për të pasur akses¹² dhe kontroll¹³ mbi ato burime¹⁴.

11 ABC-ja e të Drejtave të Punëtoveve Gra dhe Barazia Gjinore, Organizata Ndërkombëtare e Punës (2007)

12 Aksesi i referohet së drejtës ose mundësisë për përdorimin e burimeve dhe për gëzimin e përfitimeve (Fjalori i Oksfordit)

13 Kontrolli është aftësia për të vendosur mbi mënyrën e përdorimit të burimeve ose përfitimeve.

14 Burimet janë pasuritë ekonomike, politike dhe sociale; përfitimet lidhen me ushqimin, paratë, strehimin etj.

03

Financimi klimatik





Themeluar nga Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) dhe që i shërben Marrëveshjes së Parisit, Fondi i Gjelbër Klimatik (FGJK)¹⁵ është fondi më i madh në botë për klimën.

15 <https://www.greenclimate.fund/>

FGJK-ja është katalizatori për financimin e klimës. Ai përdor fondet e veta për shpejtimin e krijimit të tregut të gjelbër, duke hapur burimet financiare që u nevojiten vendeve në zhvillim për të kaluar tek rrugët e zhvillimit me emetime të ulëta dhe qëndrueshmëri ndaj klimës. Misioni i Fondit të Gjelbër Klimatik (FGJK) është mbështetja e barabartë e projekteve të përshtatjes dhe lehtësimit të efekteve të ndryshimeve klimatike përmes qasjes me në thelb vendet, e cila priorizon aksesin e drejtpërdrejtë dhe synon ato vende në zhvillim që janë në situatë vulnerabël për sa i përket klimës. Me 1,3 miliardë dollarë të investuar aktualisht, FGJK është fondi më i madh në botë i dedikuar për luftën kundër ndryshimeve klimatike.

FGJK ka për qëllim të ndikojë në tetë fusha rezultatesh për lehtësimin dhe përshtatjen: pylltaria dhe përdorimet e tjera të tokës; ndërtesat, qytetet, industritë dhe pajisjet; ekosistemet dhe shërbimet e ekosistemeve; prodhimi dhe aksesin e energjisë; siguria e shëndetit, e ushqimit dhe e ujit; infrastruktura dhe mjedisi ndërtimor; jetën e komuniteteve të prekura dhe transportin (Figura 1). Fondi synon alokimin e barabartë të burimeve të tij për lehtësimin dhe përshtatjen.




Figura 1: Fushat e rezultateve të lehtësimit dhe përshtatjes në FGJK

Më shumë informacion mbi aplikimin në FGJK për financim të projekteve të ndryshimeve klimatike dhe informacion për Autoritetin Kombëtar të Caktuar në çdo vend, mund të gjeni në linkun e mëposhtëm: <https://www.greenclimate.fund/about/partners/nda.>

<https://www.greenclimate.fund/about/partners/nda.>

Në Shtojcën 2 jepen llojet e masave të financuara nga FGJK-ja dhe disa testime për projektet e financuara prej tij.

FGJK-ja është mekanizmi i parë i financimit klimatik që përfshin perspektivat gjinore që nga fillimi i funksionimit të tij si një element thelbësor vendimmarrës për shpërndarjen e burimeve. Programi i Klimës Gjellbër (GCF) e ka vendosur gjininë si elementin kyç të arkitekturës së programeve të tij, dhe angazhimi i tij për barazi gjinore përqendrohet tek programet dhe projektet e veprimeve klimatike të përgjigjshme ndaj gjinisë që sjellin përfitime për gratë dhe burrat. Një nga dokumentet që duhet dorëzuar në aplikimin për financimin e projektit për ndryshimet klimatike është Analiza/Vlerësimi Gjinor dhe Plani i Veprimit për Përfshirjen Gjinore dhe Sociale¹⁶.

Për iniciativat kombëtare, UNDP-ja ka hartuar “Udhëzuesin për qeveritë për integrimin e ndryshimeve klimatike në buxhetim” me fokus buxhetet afatmesme. Më pas është hartuar metodologjia për etiketimin e buxhetit për klimën për iniciativat kombëtare pasi zbatimi i KKP-ve të rritura kërkon strategji financim që mobilizon burimet e sektorëve publikë dhe privatë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Shpjegimet jepen në Shtojcën 2 Etiketimi i për klimën

16 Vlerësimi gjinor dhe plani i veprimit: Shtojca 4 mbi Propozimet e Financimit të Procesit të Thjeshtuar të Miratimit | Fondi i Gjellbër Klimatik



3.1 Shembull i projektit FGJK: Bosnja dhe Hercegovina - Rritja e investimeve në ndërtesa publike me karbon të ulët

Rreth projektit:

Ulja e emetimeve të ndërtesave të sektorit publik të Bosnje-Hercegovinë përmes rritjes së efikasitetit të energjisë dhe zëvendësimit të lëndëve djegëse fosile me biomasë.

Bosnje-Hercegovina ka rezerva të mëdha ndërtesash të vjetruara që konsumojnë nivele të larta energjie dhe që ngrohen me lëndë djegëse fosile me emetim të lartë. Kjo është pasojë e neglizhencës dhe nivelit të ulët të investimeve gjatë dhe pas luftës së Bosnjës (1992-1995), duke i lënë ndërtesat në nevojë urgjente për përmirësim.

Rritja e efikasitetit të energjisë dhe zëvendësimi i qymyrit dhe naftës me biomasë do të ulë ndjeshëm emetimet nga ndërtesat publike. Projekti do të ndikojë në 7-8% të grupit të ndërtesave publike, pra rreth 360 të tilla. Po ashtu, asistenca teknike do të ndihmojë adresimin e barrierave jofinanciare dhe hartimin e politikave, rregulloreve dhe kapaciteteve mbështetëse për mbështetjen e transformimeve dhe për nxitjen e ripërsëritjes së modeleve të suksesshme. **Projekti pritet të ketë një kohëzgjatje të përcaktuar prej 20 vitesh.**

Një nga dokumentet e detyrueshme të hartuara në kuadër të projektit të Fondit të Gjelbër Klimatik është **Plani i Veprimit Gjnor**. Politika Gjnore dhe Plani i Veprimit Gjnor do të zbatohen gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit të FGJK-së dhe proceseve operacionale; zbatimi do të përbëhet nga një grup aktivitesh të dakorduara ose të paracaktuara që synojnë rritjen e kuptimit dhe mbikëqyrjes së qëllimeve organizative të lidhura me gjininë.

Plani i Veprimit Gjnor jep informacion për:

- # 1 Efikasitetin e energjisë së ndërtesave në Bosnje dhe Hercegovinë;
- # 2 Sfondin e përgjithshëm të politikave kombëtare të lidhura me gjininë dhe profilin e barazisë gjnore në BH, dhe
- # 3 Çështjet gjnore në efikasitetin e energjisë në lidhje me aksesin e grave në financa dhe fuqizimin ekonomik të grave.

Këtu përfshihet edhe një analizë gjnore që ofron një pasqyrë të situatës gjnore në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe thekson çështjet gjnore relevante për projektin e propozuar. Vlerësimi bazohet mbi të dhënat e disponueshme të studimeve të kryera nga qeveria e Bosnje-Hercegovinës, agjencitë donatore dhe partnerët e të tjerë të zhvillimit. Analiza mbështet më tej Planin e Veprimit Gjnor (Figura 2) që përfshin një grup aktivitesh që do të zbatohen nga projekti i propozuar me qëllim integrimin e plotë të zgjidhjeve për kufizimet drejt barazisë gjnore dhe fuqizimit ekonomik të grave brenda fushës së zbatimit të projektit.

Aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit do të duhet të përfshijnë qasjet e përgjigjshme gjinore dhe mbledhjen e të dhënave me ndjeshmëri gjinore. Projekti do të raportojë, pasqyrojë, kodifikojë dhe shpërndajë praktikën më të mira dhe njohuritë vlerësuese të nxjerra nga projekti për të informuar dhe ndikuar qasjen e qeverisë dhe partnerëve të tjerë të zhvillimit ndaj programeve dhe projekteve të ardhshme, në mënyrë që t'i bëjë ato gradualisht më të përgjigjshëm për sa i përket gjinisë.

PLANI I PROPOZUAR I VEPRIMIT GJINOR

Objektivi	Veprimi	Treguesi	Synimi	Kohëzgjatja	Institucioni përgjegjës
Komponenti 1. Zbutja e rrezikut nga politikat: Adresimi i pengesave jofinanciare të investimeve në ndërtesa inteligjente klimatike dhe infrastrukturë të përforcuar.					
Aktiviteti 1.1.6 Rritja e ndërgjegjësimit mes përdoruesve të ndërtesave					
Përforcimi i institucioneve në nivel bashkiak dhe qytetar, i burimeve njerëzore, i sensibilizimit dhe njohurive për politikëbërje me ndjeshmëri gjinore dhe inteligjente klimatike	Përfshirja aktive e grave në ndërtimin e kapaciteteve dhe në zhvillimin e seminareve për ndërgjegjësim	Numri i stafit teknik dhe i atij politikëbërës (% e grave) të trajnuar në sektorin publik	200 (30% gra)	EoP (në fund të projektit)	Përfaqësuesit bashkiakë, qytetarë dhe të qeverisë
		Numri i masave sociale me ndjeshmëri gjinore (duke përfshirë masat e synuara që lehtësojnë lidhjet energjetike për familjet që drejtohen nga gratë dhe për familjet vulnerabël) të përfshira në SECAP që mbështeten nga projekti	20	EoP	Projekt i UNDP-së
		Numri i SECAP me ndjeshmëri gjinore të mbështetur nga projektit	40	EoP	
Rritja e kuptimit të përfitimeve të zgjidhjeve inteligjente klimatike në nivel komuniteti	Organizimi i fushatave të PR-it në mbarë vendin që konsistojnë në një sërë eventesh të projektuara rreth nevojave dhe roleve të ndryshme gjinore, përgjegjësive dhe aksesit të grave në energji dhe në përdorimin e saj.	Numri i eventeve të PR-it (duke përfshirë transmetime mediatike) që nxjerrin në pah sfidat dhe mundësitë për adresimin e nevojave të grave dhe burrave në lidhje me shërbimin dhe përdorimin e energjisë	40	Eop	Ekipi i projektit të UNDP-së
		Numri i pjesëmarrësve të trajnuar (30% gra) në zgjidhjet e energjisë së pastër në ndërtim dhe në mirëmbajtjen e teknologjive të instaluar efikase për energjinë	500	Në fund të vitit të 2-të	Institucione bashkiake dhe lokale
	Mobilizimi i komuniteteve lokale për pjesëmarrje në aktivitete dhe evente me bazë gjinore				OQJ-të e grave të identifikuara gjatë zbatimit të projektit

Figura 2: Plani i Propozuar i Veprimit nga FGJK-ja në Bosnjë dhe Hercegovinë

04

Perspektiva gjinore
për financimin
e ndryshimeve
klimatike



Në rastin e iniciativave (projekteve/programeve) të ndryshimeve klimatike në nivel lokal ose kombëtar, një analizë/vlerësim gjinor i bërë mirë ndihmon identifikimin e shkaqeve të shumta të vulnerabilitetit, përfshirë pabarazinë gjinore. Analiza dhe vlerësimi ndihmojnë gjithashtu edhe identifikimin dhe krijimin e njohurive e ndërtimin e kapaciteteve të ndryshme brenda komuniteteve/familjeve që mund të përdoren për rritjen e qëndrueshmërisë së tyre ndaj goditjeve dhe rreziqeve të lidhura me klimën.

Analiza gjinore¹⁷ siguron të dhëna dhe informacionin e nevojshëm për integrimin e perspektivës gjinore në politika, programe dhe projekte. Një nga mjetet që kap shpërndarjen e **llojeve të rezultateve gjinore të ndërhyrjeve ose politikave** me pesë kategori është Korniza e Efikasitetit të Rezultateve Gjinore (KERGJ)¹⁸ e cila ofron udhëzime për zbatimin e analizës së përgjigjshme gjinore të rezultateve në vlerësimet e skenarëve të ndryshëm të përdorimit. Ajo tregon mënyrën e përfshirjes së KERGJ në fazat e projektimit, zbatimit dhe vlerësimit të programit. Qëllimi i KERGJ është dhënia e udhëzimeve vlerësuesve për zbatimin e analizave të përgjigjshme gjinore të rezultateve të vlerësimeve dhe përlogaritjeve. Shkalla e mëposhtme është përdorur për renditjen e ndërhyrjeve dhe aktiviteteve të integritit gjinor: negativ ndaj gjinisë, i verbër (i pandjeshëm) ndaj gjinisë, i ndjeshëm ndaj gjinisë, i përgjigjshëm ndaj gjinisë dhe transformues ndaj gjinisë, në varësi të faktit nëse ndërhyrja/politika merr parasysh pasiguritë gjinore.



OSHC-të mund të përdorin pyetjet udhëzuese të mëposhtme për vlerësimin e iniciativave dhe ndërhyrjeve¹⁹ (programeve, projekteve) dhe gjurmimin e financimit, si dhe efektet negative e pozitive të veprimeve klimatike mbi barazinë gjinore, përmes prizmit të integritit gjinor, në çdo fazë të ndërhyrjeve pa marrë parasysh nëse ato zbatohen nga aktorë shtetërorë apo nga OSHC (projektimi i ndërhyrjes, zbatimi i ndërhyrjes, monitorimi i zbatimit dhe vlerësimi i ndërhyrjeve):

17 Analiza gjinore | EIGE (europa.eu)

18 GRES_English.pdf(undp.org)

19 Pyetjet udhëzuese për vlerësimin e iniciativave (programeve, projekteve) për aktivitetet dhe veprimet e ndryshimeve klimatike përmes prizmit të integritit gjinor bazohen në dokumentet e mëposhtme: Si të kryhet një analizë gjinore: Një shënim udhëzues për stafin e UNDP-së (2016), Korniza e Efektivitetit të Rezultateve Gjinore (KERGJ) që kap llojet e rezultateve gjinore me pesë kategori, Shënim udhëzues i Ekipit Vendor të OKB-së (UNCT) për shënjesin e barazisë gjinore, Metodologjia e Fondit të Gjelbër Klimatik (FGJK) dhe Metodologjia për kryerjen e analizës gjinore të zhvilluar nga Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (IEBGJ).

1. A janë adresuar nevojat/prioritetet e ndryshme të grave dhe burrave në fazën e projektimit dhe hartimit të nismës: Cila është situata e grave dhe burrave në sektorin specifik të ndërrhyrjes ose në zonën e ndikimit të iniciativës? Për sa i përket iniciativës së propozuar që do të financohet, a do të ketë dallime të parashikuara sa i përket vulnerabilitetit të burrave dhe grave? A do të kenë apo jo problemet e identifikuar të ndryshimeve klimatike të njëjtin ndikim tek gratë dhe burrat? Cilat janë burimet (ekonomike, financiare, fizike, natyrore, asete të tjera) tek të cilat kanë akses gratë dhe burrat? Kush e menaxhon ose e kontrollon aksesin në këto burime? A përfshihet apo jo informacioni i disagreguar në analizën e problemit? A ka hendek të identifikuar gjinor dhe nëse po, cilat janë shkaqet kryesore të këtyre boshllëqeve që lidhen me analizën e problemit?

Shembull: Ndotja e ajrit të qyteteve kontribuon drejtpërdrejt në ndryshimet klimatike, por projektet për uljen e ndotjes së ajrit duhet të kenë parasysh se ka ndotje të ajrit të brendshëm dhe të jashtëm dhe ndonjëherë, ndotja e brendshme është shumë më e lartë se ndotja e jashtme. Meqenëse njerëzit zakonisht punojnë në ndërtime ose punë për të cilat nevojitet të lëvizin ose transport, atëherë ata do të jenë më të ekspozuar ndaj ndotjes së jashtme. Gratë nga ana tjetër, po kalojnë 3-4 herë më shumë kohë në shtëpi dhe kanë punë të brendshme (punëtore tekstile, mësuese, infermiere...), ndaj gratë do të jenë më të ekspozuara ndaj ndotjes së brendshme. A kemi statistika për vdekjet e grave/burrave sipas grupmoshave të shkaktuara nga ndotja e ajrit? A ka një numër bebesh të lindur të vdekur ose abortesh si pasojë e ekspozimit të gjatë në ajër të ndotur? A ka ndryshime të zakoneve të ngrohjes së grave dhe burrave duke marrë gjithashtu në konsideratë gjininë dhe komoditetin termik dhe perceptimin individual të cilësisë së mjedisit të brendshëm²⁰.

20 [Gender Matters! Thermal Comfort and Individual Perception of Indoor Environmental Quality: A Literature Review | SpringerLink](#)

2. Identifikimi i kapaciteteve ekzistuese kombëtare në përgjigje të pabarazive gjinore të lidhura me problemin që do të trajtojë iniciativa: A merren parasysh rekomandimet për vendin të bëra nga organizatat e OKB-së dhe mekanizmat raportues (CEDAW, UPR...)? A janë identifikuar avantazhet krahasimore të asistencës së OKB-së apo të organizatave të tjera ndërkombëtare? A lidhet dhe a koordinohet iniciativa me palët gjinore të interesit (organizatat dhe strukturat e grave) dhe/ose me ekspertët?

Shembull: Të gjitha vendet e përfshira në projekt janë aspirante për anëtarësim në BE dhe kanë ratifikuar pjesën më të madhe të dokumenteve detyruese ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut, gjininë dhe klimën. Vendet tona janë të detyruara të paraqesin raporte për progresin në bazë të çdo konvente, dhe BE-ja po ashtu nxjerr raporte vjetore për progresin e vendeve. Raporte janë burime të vlefshme informacioni.

3. Strategjitë e ndërhyrjes: A i ka identifikuar ndërhyrja vulnerabilitetet e dallueshme të grave dhe të burrave dhe a ka zhvilluar ajo strategji specifike reagimi për secilin grup të synuar? A do të jetë në gjendje ndërhyrja të adresojë nevojat dhe prioritetet përkatëse të grave dhe burrave? Nëse po, si? A ka ndërhyrja ndikim negativ të parashikuar tek gratë dhe burrat (p.sh. rritje e ngarkesës së punës, humbja e aksesit në burime si kredi, ujë, tokë dhe teknologji)? A i pakëson apo sfidon ndërhyrja pabarazitë ekzistuese në situatën e burrave dhe grave? A do t'i ndryshojë ndërhyrja perceptimet apo stereotipet ekzistuese për gratë dhe burrat, si dhe për rolet e tyre? A ka mekanizma specifike të propozuar për të nxitur dhe mundësuar pjesëmarrjen e grave në ndërhyrje, pavarësisht pozicionit të tyre të pafavorshëm? A parashikohet ndikimi afatgjatë i rritjes së aftësisë së grave për të marrë drejtimin e jetës së tyre, si dhe për ndërmarrjen e veprimeve kolektive për zgjidhjen e problemeve?

Shembull: Nëse projekti po mbështet subvencionimin e pajisjeve për ngrohje në shtëpi, kush është ai që vendos se çfarë pajisjeje do të subvencionohet dhe si do të përdoret? Çfarë masash mund të marrim për nxitjen e aplikimeve të grave për subvencionim?

4. Ndërhyrja (projekti/programi) Rezultatet: Cilët janë objektivat e qarta gjinore të përshkruara në propozimin e ndërhyrjes? Çfarë lloj mjedesh dhe veprimesh janë identifikuar për të adresuar pabarazitë e mundshme gjinore që dalin nga ndërhyrja? A mund t'i zvogëlojnë pabarazitë gjinore rezultatet dhe aktivitetet e përfshira në masat e zhvillimit të kapaciteteve? A kanë gratë dhe burrat e komuniteteve vulnerabël akses të barabartë në informacionin dhe mundësitë e nevojshme për të marrë pjesë dhe për të përfituar plotësisht nga rezultatet e pritura të ndërhyrjes? A përdoren njohuritë dhe aftësitë specifike të grave dhe burrave, veçanërisht nga grupet vulnerabël për të kontribuar në rezultatet dhe zgjidhjet e projektit? A ka identifikuar ndërhyrja mundësi për të sfiduar stereotipet gjinore dhe për të përmirësuar marrëdhëniet pozitive gjinore përmes veprimeve të barabarta? Nëse po, cilat janë këto mundësi dhe veprime. A është aksesit dhe pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave kriter kyç i përcaktuar në projekt për mundësitë, përfitimet dhe burimet? A do të jenë shërbimet, zhvillimi i kapaciteteve dhe teknologjitë e ofruara nga ndërhyrja të disponueshme dhe të arritshme për të dy gjinitë, si për gratë dhe burrat? A përfshin ndërhyrja tregues gjinor?

Shembull: Gratë nuk nxiten të marrin pjesë ose të japin mendimet e tyre për zgjidhjet kur diskutohet për ndryshimet klimatike (përshtatjen apo masat lehtësuese). Nëse ka një masë që adreson specifikisht mbledhjen e ideve të grave për organizimin e misionëve të shpëtimit nga përmytjet apo zjarret, atëherë ajo do të konsiderohej si masë me ndjeshmëri gjinore ose specifike për gjininë.

5. Buxheti i ndërhyrjes: A shoqërohen aktivitetet e përgjigjshme gjinore me buxhet brenda buxhetit për veprimet klimatike, për të garantuar zbatimin e tyre? A ka alokim burimesh me fokus gjinor për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave? A është i mundur gjurmimi i rrjedhës së këtyre burimeve?

Shembull: A është e mundur të lexohen dhe të gjurmohen fondet për masën nga shembulli i mëparshëm (duke u kërkuar grave ide për misione shpëtimi)? Në këtë fazë, mund të zbatohen disa nga mjetet e BPGJ-së si (analiza e kostove dhe e përfitimeve të buxhetimit gjinor, analiza e buxhetimit gjinor për efikasitetin, analiza e buxhetimit gjinor për shpenzimet dhe të ardhurat).

B

Faza e zbatimit /menaxhimi i iniciativës:

Pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në strukturat e menaxhimit si përfitues, partnerë dhe palë kyçe interesi? • Pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në proceset e vendimmarrjes? Përdorimi i gjuhës miqësore ndaj gjinisë? Mjetet për nxitjen e pjesëmarrjes së grave në menaxhimin e ndërhyrjes? A përfshin stafi i zbatimit të ndërhyrjes ekspertë gjinorë dhe/ose të përfshirjes sociale? A e zhvillon ndërhyrja kapacitetin e stafit për adresimin e konsideratave gjinore dhe përdorimin e mjeteve të përgjigjshme gjinore dhe pjesëmarrëse në kontekstin e ndërhyrjes dhe zbatimit të saj?

Shembull: Përgjigja e zakonshme kur kuptohet se nuk ka inxhinierë gra në ndërhyrjet e ndryshimeve klimatike. Nëse monitorimi i procesit të angazhimit të stafit të projektit pasqyron situatën, atëherë një nga masat e sugjeruara mund të jetë lidhja me fakultetet teknike dhe identifikimin e grave inxhinierë, si dhe gjetja e një pozicioni të përkohshëm pune për ta, pasi shumë gra inxhinierë, për shkak të paragjykimeve gjinore, janë të punësuara në sektorë të tjerë, zakonisht me diplomën e shkollës së mesme.






A përfshin kuadri i monitorimit masa për monitorimin dhe vlerësimin e progresit në barazinë gjinore? A përfshihen në kuadër tregues të matshëm gjinore të përshtatshëm për ndërhyrjen? A ka mjete për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë (të disagreguara sipas gjinisë)? A ka aktivitete, burime dhe përgjegjësi specifike për gjurmimin e kontributeve të ndërhyrjes në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave?

Shembull: Në këtë pjesë, duhet të specifikohen mjetet për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe në cilat aktivitete, çfarë burimesh janë të nevojshme dhe cilat janë përgjegjësitë për ndjekjen e kontributeve të ndërhyrjeve (projektit/programit) në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Për ndërhyrjet e ndryshimeve klimatike që përfshijnë studime dhe kërkime, duhet t'i kushtohet vëmendje faktit nëse studimi përfshin komponentin gjinor apo jo. Kërkim-studimet me ndjeshmëri gjinore²¹ marrin parasysh dallimet mes burrave dhe grave në të gjitha aspektet e tyre, duke u nisur nga ideja fillestare, formulimi i pyetjeve, objektivave dhe metodologjive kërkimore deri te rezultatet dhe prezantimi i tyre. Përveç integritit gjinore në përmbajtje, qasja me ndjeshmëri gjinore ka për qëllim garantimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në punën shkencore.

Informacioni bazë i ndarë sipas gjinisë është thelbësor²² për të demonstruar ndryshimet gjatë kohëzgjatjes së një programi, projekti apo iniciative²³. Informacioni bazë bëhet pika e referimit për vlerësimin e rezultateve të barazisë gjinore. Gjatë vlerësimit të ndryshimeve të marrëdhënieve gjinore, informacioni bazë duhet të nxirret nga analiza cilësore gjinore dhe sociale.

Pyetjet themelore për shqyrtimin e studimeve me perspektiva gjinore janë:

-  Përbërja e ekipeve të kërkimit (përfshirja e studiuesve gra dhe burra)
-  Mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë (qasja ndërseksionale)
-  Identifikimi i hendekut gjinor në varësi të fushës së zbatimit të studimit që mund të ndikojë në aktivitetet e mëtejshme të iniciativave duke përdorur teorinë e sjelljes

21 Paketa e instrumenteve për integrimin e qasjes me ndjeshmëri gjinore në kërkime dhe mësimdhënie: [garcia_toolkit_gender_research_teaching.pdf \(europa.eu\)](https://ec.europa.eu/garcia_toolkit_gender_research_teaching.pdf)

22 Kërkimi gjinor: Udhëzues për mënyrën e kryerjes së kërkimit gjinor: [A How-To Guide: Microsoft Word - HOW_TO.doc \(genderaveda.cz\)](https://genderaveda.cz/A_How-To_Guide:_Microsoft_Word_-_HOW_TO.doc)

23 Hyrje në Barazinë Gjinore dhe Treguesit e Fuqizimit të Grave

Të gjitha pyetjet udhëzuese të mësipërme mund t'i ndihmojnë OSHC-të, por edhe të gjitha palët e tjera të interesit, në etiketimin e buxhetit gjinor, pra duke ndjekur mënyrën e mbështetjes së objektivave të barazisë gjinore nga programet dhe aktivitetet, si dhe duke ndihmuar në përcaktimin sasior të flukseve financiare.

Shumë nga instrumentet financiare për ndryshimet klimatike e kanë zbatuar integrimin gjinor si parimin dhe elementin kyç të arkitekturës së tij programore; dhe, angazhimi i tyre ndaj barazisë gjinore përqendrohet tek programet dhe projektet e veprimeve të përgjigjshme gjinore nga të cilat përfitojnë gratë dhe burrat.

Fondi i Gjelbër Klimatik - FGJK është element vendimtar i Marrëveshjes historike të Parisit - është fondi më i madh klimatik në botë, i mandatuar për të mbështetur vendet në zhvillim për ngritjen dhe realizimin e ambicieve të tyre të Kontributeve Kombëtare të Pikësnuara (KKP) drejt rrugëve me emetim të ulët dhe me qëndrueshmëri klimatike. Integrimi gjinor është thelbësor për objektivat dhe parimet udhëzuese të FGJK-së, duke përfshirë angazhimin e grave dhe burrave të të gjitha moshave si palë interesi në hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e strategjive dhe aktiviteteve që do të financohen.

Për projektet që paraqiten përpara Fondit të Gjelbër Klimatik, duhet theksuar se integrimi gjinor është thelbësor për objektivat dhe parimet udhëzuese të Fondit Global të Klimës, duke përfshirë angazhimin e grave dhe burrave të të gjitha moshave si palë interesi në hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e strategjive dhe aktiviteteve të financuara. FGJK-ja ka hartuar një manual: Integrimi gjinor në projektet e Fondit të Gjelbër Klimatik, i cili mund të shkarkohet në linkun e mëposhtëm: [Përfshirja e gjinisë në projektet e Fondit të Gjelbër Klimatik | Fondi i Gjelbër Klimatik](#)



05

Shtojcat





Shtojca 1

Sektori prioritar për masat e zbatimit për të lehtësuar ose për t'u përshtatur me ndikimet e ndryshimeve klimatike në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe shembuj të masave të përcaktuara në dokumentet e përditësuara të KKP-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Kontributet Kombëtare të Pikësnyuara janë një plan veprimi klimatik për uljen e emetimeve dhe përshtatjen ndaj ndikimeve të klimës. Plani i KKP-ve përfshin politika dhe masa që qeveritë synojnë t'i zbatojnë si përgjigje ndaj ndryshimeve klimatike dhe si kontribut për të arritur objektivat globale të përcaktuara në Marrëveshjen e Parisit.

KKP-të janë objektivat e para të gazeve serrë në kuadër të UNFCCC që aplikohen njëkohësisht si për vendet e zhvilluara, ashtu dhe për ato në zhvillim.

KKP-të nevojiten kur vendet vendosin objektiva për lehtësimin e gazeve serrë që shkaktojnë ndryshimet klimatike dhe objektiva për përshtatjen ndaj ndikimeve të klimës. Planet përcaktojnë mënyrën e arritjes së objektivave dhe zhvillojnë sisteme për monitorimin dhe verifikimin e ecurisë me qëllim që kjo e fundit të mbetet në rrugën e duhur.

Sipas Kontributeve Kombëtare të Pikësnyuara, sektorët prioritarë për zbatimin e masave për lehtësimin dhe reduktimin ose për përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në vendet e Ballkanit Perëndimor shfaqen në Tabela 2 dhe në Tabela 3.

Tabela 2: Sektorët prioritarë për zbatimin e masave për lehtësimin dhe reduktimin e ndikimeve nga ndryshimet klimatike në Ballkanin Perëndimor

Sektori prioritar / Shteti	Republika e Kosovës	Republika e Serbisë	Republika e Shqipërisë	Republika e Maqedonisë së Veriut	Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës	Republika e Malit të Zi
Prodhimi i energjisë dhe aksesit në energji (së bashku me PIPP)						
Bujqësia, Pylltaria dhe përdorimet e formave të tjera të tokës						
Ndërtesat, qytetet, industrinë dhe pajisjet						
Transporti						
Mbetjet						

Tabela 3: Sektorët prioritarë për zbatimin e masave për përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor

Sektori prioritar / Shteti	Republika e Kosovës	Republika e Serbisë	Republika e Shqipërisë	Republika e Maqedonisë së Veriut	Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës	Republika e Malit të Zi
Ekosistemet dhe shërbimet e ekosistemit						
Infrastruktura dhe mjedisi ndërtimor						
Mjetet e jetesës së komuniteteve vulnerabël						
Siguria ushqimore dhe e ujit të shëndetshëm						
Bujqësia, Pylltaria dhe përdorimet e formave të tjera të tokës						
Turizmi						

Sektorët me prioritet më të lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor (Republika e Kosovës, Republika e Shqipërisë, Republika e Serbisë, Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Bosnjë-Hercegovinës dhe Republika e Malit të Zi) janë Bujqësia, Pylltaria dhe përdorimet e formave të tjera të tokës, prodhimi i energjisë dhe aksesimi në të (së bashku me PIPP) dhe siguria ushqimore dhe e ujit të shëndetshëm.

Më poshtë jepen disa shembuj të masave të përcaktuara në dokumentet e përditësuara të KKP-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor..

Shembull i masave lehtësuese nga Republika e Maqedonisë së veriut për sektorët prioritarë të lidhur me klimën

Mbetjet - Asgjësimi i mbetjeve të ngurta për të zbutur dhe reduktuar ndikimet e ndryshimeve klimatike

Mbrojtja e mjedisit dhe përmbushja e standardeve më të larta evropiane:

- Rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese dhe venddepozitimeve të paligjshme (“të egra”) me rrezik shumë të lartë, të lartë dhe të mesëm në secilin nga pesë rajonet e menaxhimit të mbetjeve. Mbyllja e venddepozitimeve ekzistuese.
- Hapja e venddepozitimeve të reja rajonale në të gjitha rajonet e menaxhimit të mbetjeve me sistem të instaluar për trajtimin mekanik, biologjik dhe kompostimin. Trajtimi mekanik dhe biologjik (TMB) në venddepozitimet e reja me kompostim.

Shembull nga Republika e Malit të Zi për sektorin prioritar të energjisë **Termocentrale të reja të rinovueshme për të zbutur dhe reduktuar ndikimet e ndryshimeve klimatike**

Planifikohen impiantet e mëposhtme të rinovueshme:

- Njësi e re turbine-gjenerator në HEC-in Perucica (shtesë 58,5 MW, 50 GWh).
- Rikonstruksion i HEC-it Piva (pa kapacitet shtesë).
- Impiant me energji ere (WPP) Gvozd (54,6, MW, 150 GWh)
- WPP Brajici (100MW, 277GWh)
- Impiant me energji solare (SPP) Briska Gora(250MW, 450 GWh)
- Hidrocentral (HPP) Komarnica (172 MW, 213GWh)
- SPP Velje Brdo (50 MW, 90 GWh)
- SPP Prosumers (10 MW, 18 GWh)

Shembuj të masave në Republikën e Shqipërisë në sektorin e turizmit **Masat për përshtatjen ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike**

Përmirësimi i infrastrukturës rezidenciale dhe produktive, i akomodimeve turistike, aseteve dhe objekteve shëndetësore (dhe objekte të tjera shoqërore) për t'i bërë ato rezistente ndaj ndryshimeve klimatike.

- Përmirësimi klimatik i ndërtesave (mbulimi i mureve dhe çatisë së ndërtesave me materiale izoluese termike, përdorimi i dritareve dhe dyerve me xham të dyfishtë, përdorimi i çatave të gjelbra, ventilimi natyral, rregullimi i rrugëve të evakuimit për shpëtim nga zjarri dhe sistemet e mbrojtjes nga zjarri)

Përmirësimi klimatik i ndërtesave dhe objekteve bregdetare për parandalimin e dëmeve dhe degradimit të mëtejshëm:

- Përcaktimi i zonave mbrojtëse (jeshile dhe blu) në zonat me rrezik (bregdetare dhe tokësore).
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës mbrojtëse (p.sh., strukturat mbrojtëse bregdetare/portat e betonit, rritja e nivelit të shtretërve të lumenjve (pastrimi nga sedimentet, zgjerimi i kanaleve)).

Masat e përshtatjes në Republikën e Serbisë në sektorin prioritar të ujit:

Rritja e efikasitetit të sistemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë:

- Uljen optimale të humbjeve
- Vendosjen e çmimeve ekonomike të ujit të pijshëm
- Organizimi optimal i punimeve ujore
- Zbatimi i teknikave më të mira të disponueshme të ujitjes dhe bashkëpunimi me vendet e sipërme (komisionet dypalëshe për sasinë e ujit)
- Reduktimi e përdorimeve specifike të ujit nga industria dhe ujitja, veçanërisht për sistemet e reja industriale dhe të ujitjes
- Transferimi i ujit nga rajonet e pasura me ujë në zonat me mungesë uji.



Shtojca 2

Llojet e masave financuara nga FGJK-ja dhe disa testimet për projektet e financuara nga ajo



Lehtësimi: në kontekstin e ndryshimeve klimatike konsiderohet ndërhyrja njerëzore për reduktimin e burimeve ose për rritjen e depozitave të gazeve serrë. Si shembuj lehtësimi mund të përmendim përdorimin më efikas të lëndëve djegëse fosile për proceset industriale ose gjenerimin e energjisë elektrike, kalimin në energji diellore ose në energji të erës, përmirësimin e izolimit të ndërtesave dhe zgjerimin e pyjeve dhe “rezervave” të tjera për largimin e sasive më të mëdha të dioksidit të karbonit nga atmosfera.

Shembull: Projekt-ideja me qëllim kryesor promovimin e investimeve të burimeve të rinovueshme të energjisë (aktivitetet do të çojnë në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë)

Përshtatja: përshtatje ndaj sistemeve natyrore ose njerëzore si reagim ndaj stimuljeve aktualë ose të pritshëm klimatikë apo efekteve të tyre, të cilat zvogëlojnë dëmin ose shfrytëzojnë mundësitë e dobishme.

Shembull: Projekt-ideja me qëllim kryesor zhvillimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm në zonat e cenueshme nga përmbytjet (aktivitetet do të forcojnë qëndrueshmërinë ndaj përmbytjeve).

**** Kujdes: Projekt-ideja duhet të jetë në përputhje me të paktën një nga sektorët prioritarë kombëtarë ****

Shembuj të projekteve të financuara nga FGJK-ja dhe fusha e rezultateve përkatëse të FGJK-së:

Shembulli 1: Projekti për rritjen e investimeve në ndërtesat publike me karbon të ulët në Bosnjë dhe Hercegovinë është fokusuar vetëm te rezultatet e lehtësimit të FGJK-së, veçanërisht në ndërtesa, qytete, industri dhe pajisje, për shkak të faktit se qëllimi kryesor i projektit dhe aktivitetet e projektit përqendrohen tek zbatimi i rikonstruksioneve të ndërtesave me karbon të ulët në 430 ndërtesa publike, me masa efikase për energjinë e përdorur dhe me masa për energjinë e rinovueshme. Për më shumë detaje, vizitoni: www.greenclimate.fund/projects/fp051

Shembulli 2: Projekti për mbështetjen e qëndrueshmërisë klimatike dhe ndryshimet transformuese në sektorin e bujqësisë në Butan është fokusuar në disa fusha rezultatesh të FGJK-së: Shëndeti, siguria e ushqimit dhe e ujit, mjetet e jetesës së njerëzve dhe e komuniteteve, si dhe infrastruktura dhe mjedisi i ndërtuar. Aktivitetet kryesore do të promovojnë praktikën bujqësore të qëndrueshme ndaj klimës, do të integrojnë të dhënat mbi rrezikun e ndryshimeve klimatike në menaxhimin e ujit dhe të tokës për të mbështetur fermerët e vegjël dhe do të zvogëlojnë rrezikun dhe ndikimin e rrëshqitjeve të dheut të shkaktuara nga ndryshimet klimatike gjatë ndodhjeve ekstreme që prishin aksesin në treg. Për më shumë detaje, vizitoni: www.greenclimate.fund/projects/fp107

Shembulli 3: Programi i kredive për konsum efikas të energjisë në Mongoli është fokusuar në dy fusha rezultatesh të FGJK-së: Prodhimi dhe aksesimi i energjisë dhe ndërtesat, qytetet, industrinë e pajisjet. Programi do të ofrojë kredi për pajisjet e ngrohjes me efikasitet të lartë energjie dhe për produktet e strehimit, me pajisje ngrohëse të certifikuar me qëllim arritjen e të paktën një reduktimi prej 20 për qind në përdorimin e energjisë. Përdorimi i financimit të grantit do të përfshijë asgjësimin e pajisjeve të vjetra të ngrohjes dhe të strehimit me efikasitet energjetik, duke kontribuar gjithashtu në ndryshimin e sjelljes së konsumatorëve. Për më shumë detaje, vizitoni: www.greenclimate.fund/projects/sap004

Shembulli 4: Programi për Qytetet e Gjelbra fokusohet në disa fusha rezultatesh të FGJK-së: Prodhimi dhe aksesimi i energjisë, transporti, ndërtesat, qytetet, industrinë dhe pajisjet, mjetet e jetesës së njerëzve dhe komuniteteve dhe infrastruktura e mjedisit ndërtimor. Programi për Qytetet e Gjelbra do të adresojë sfidat e ndryshimeve klimatike në qytete, teksa ndërton edhe argumentin tregtar për investime të sektorit privat në infrastrukturën të qëndrueshme urbane. Programi bazohet tek qasja e drejtuar nga vendi dhe e bazuar në prova, që sistematizohet përmbush dhe pastaj financon investime transformuese të infrastrukturës klimatike komunale. Për më shumë detaje, vizitoni: www.greenclimate.fund/projects/fp086

Analiza gjinore duhet të bëhet në fazën të hershme të procesit të planifikimit në mënyrë që njohja e rolit të gjinisë dhe marrëdhënieve të pushtetit të integrohet në projekt. Të gjitha projektet/programet duhet të përfshijnë analizën gjinore dhe të dhënat mbi çështjet gjinore në analizën e situatës së përgjithshme.

Analiza/vlerësimi gjinor i referohet metodave të përdorura për kuptimin e marrëdhënieve mes burrave dhe grave, aksesin e tyre në burime, aktivitetet e tyre dhe kufizimet me të cilat përballen në raport me njëri-tjetrin. Analiza/vlerësimi gjithëpërfshirës gjinor përfshin shqyrtimin e roleve, të të drejtave, nevojave dhe mundësive të ndryshme të grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në një projekt/program të caktuar. Këto analiza dhe vlerësime ndihmojnë promovimin e pikave hyrëse përkatëse gjinore, politikave dhe identifikojnë mundësitë për rritjen e barazisë gjinore në një projekt/program të caktuar. Në rastin e projekteve/programëve të ndryshimeve klimatike, një analizë/vlerësim gjinor i bërë mirë ndihmon identifikimin e shkaqeve të shumta të vulnerabilitetit, përfshirë pabarazinë gjinore.



Pyetjet për analizën/vlerësimin gjinor që duhen adresuar në fazën planifikuese/përgatitore të projektit:

1. Cila është shkalla e vdekshmërisë amtare, shkalla e vdekshmërisë së foshnjave, statusi arsimor i vajzave dhe djemve, shkalla e arsimimit të të rriturve (të ndara sipas gjinisë), shkalla e varfërisë, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (të ndara sipas gjinisë), shkalla e punësimit (të ndara sipas gjinisë), shkalla e papunësisë (të ndara sipas gjinisë), shkalla e pjesëmarrjes politike (të ndara sipas gjinisë), shkalla e jetëgjatësisë (të ndara sipas gjinisë) në vendin e ndërhyrjes dhe/ose zonën e ndikimit të projektit/programit?
2. Cili është statusi ligjor i grave në vendin e ndërhyrjes?
3. Cilat janë besimet, perceptimet dhe stereotipet e zakonshme që lidhen me gjininë në zonën e ndikimit të projektit/programit ose në vendin e ndërhyrjes?
4. Cila është ndarja e punës mes grave dhe burrave në zonën e ndikimit të projektit/programit dhe/ose në vendin e ndërhyrjes?
5. Cila është pjesëmarrja mes grave dhe burrave në ekonominë formale/joformale në vendin e ndërhyrjes ose në zonën e ndikimit të projektit/programit?
6. Cila është situata e grave dhe burrave në sektorin specifik të ndërhyrjes ose në zonën e ndikimit të projektit/programit?
7. Në lidhje me projektin/programin e propozuar, a pritet të ketë dallime të parashikuara të vulnerabilitetit dhe kapacitetit për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike midis burrave dhe grave? Nëse po, cilat janë këto dallime?
8. A ka pabarazi gjinore ekzistuese që mund të përkeqësohen nga ndikimet e ndryshimeve klimatike në zonën e ndikimit të projektit/programit të propozuar?
9. Cilat janë disa nga mosbarazitë që ekzistojnë mes grupeve të ndryshme sociale në zonën e ndikimit të projektit/programit? Si ndikojnë këto pasiguri në kapacitetin e njerëzve për të përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike?
10. Çfarë roli pritet të luajnë gratë dhe burrat në kontekstin e projektit/programit? Çfarë përfshijnë këto role për sa i përket angazhimit në kohë dhe nevojës për lëvizshmëri?
11. Cilat janë burimet (ekonomike, financiare, fizike, natyrore, asete të tjera) tek të cilat kanë akses gratë dhe burrat? Kush e menaxhon ose e kontrollon aksesin në këto burime?
12. A kanë gratë dhe burrat e komuniteteve vulnerabël akses të barabartë në informacionin dhe mundësitë e nevojshme për të marrë pjesë dhe për të përfituar plotësisht nga rezultatet e pritura të projektit/programit?
13. A kanë gratë akses të barabartë në arsim, njohuri teknike dhe/ose rritje të aftësive?
14. A do të jenë shërbimet dhe teknologjitë e ofruara nga projekti/programi të disponueshme dhe të arritshme për të dy gjinitë, si për gratë dhe burrat?
15. Në çfarë masë marrin pjesë gratë dhe burrat e komuniteteve vulnerabël në proceset e vendimmarrjes? Çfarë lloji vendimesh merren nga gratë? Cilat janë kufizimet (sociale, kulturore, ekonomike, politike) që kufizojnë pjesëmarrjen aktive të grave në proceset e vendimmarrjes në nivel familjeje dhe komuniteti?

16. A ka mundësi promovimi të lidërshiptit të grave në sistemet lokale të qeverisjes/politike dhe në institucionet formale/joformale? Nëse jo, cilat janë disa nga kufizimet që i pengojnë gratë të kenë role lidërshipti?
17. Cilat janë nevojat/prioritetet e ndryshme të grave dhe burrave në kontekstin e projektit/programit? A do të arrijë projekti/programi të adresojë nevojat dhe prioritetet e tyre përkatëse? Nëse po, si?
18. A janë marrë në konsideratë nga projekti/programi nevojat e grupmoshave të veçanta (dhe vulnerabël) (si p.sh., fëmijët, vajzat, gratë dhe burrat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, vejushat)?
19. A i ka identifikuar ndërhyrja vulnerabilitetet e dallueshme të grave dhe të burrave dhe a ka zhvilluar ajo strategji specifike reagimi për secilin grup të synuar?
20. A përdoren njohuritë dhe aftësitë specifike të grave dhe burrave, veçanërisht nga grupet vulnerabël për të kontribuar në rezultatet dhe zgjidhjet e projektit/programit?
21. A ka identifikuar projekti/programi mundësi për të sfiduar stereotipet gjinore dhe për të përmirësuar marrëdhëniet pozitive gjinore përmes veprimeve të barabarta? Nëse po, cilat janë këto mundësi dhe veprime?

FGJK-ja është mekanizmi i parë i financimit klimatik që përfshin perspektivat gjinore që nga fillimi i funksionimit të tij si një element thelbësor vendimmarrës për shpërndarjen e burimeve. Programi i Klimës Gjelbër (GCF) e ka vendosur gjininë si elementin kyç të arkitekturës së programeve të tij, dhe angazhimi i tij për barazi gjinore përqendrohet tek programet dhe projektet e veprimeve klimatike të përgjigjshme ndaj gjinisë që sjellin përfitime për gratë dhe burrat.



Shtojca 3

Etiketimi i buxhetit klimatik



Për iniciativat kombëtare, UNDP-ja ka hartuar “Udhëzuesin për qeveritë për integrimin e ndryshimeve klimatike në buxhetim” me fokus buxhetet afatmesme. Linku: [Buxhetimi për ndryshimet klimatike: Një shënim udhëzues për qeveritë për integrimin e ndryshimeve klimatike në buxhetim | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim \(undp.org\)](#).

Më pas është hartuar metodologjia për etiketimin e buxhetit për klimën për iniciativat kombëtare pasi zbatimi i KKP-ve të rritura kërkon strategji financim që mobilizon burimet e sektorëve publikë dhe privatë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Shumica e ndihmës së marrë ndërkombëtare është përdorur për të financuar projekte që kryesisht zvogëlojnë efektet e ndryshimeve klimatike. Një përçindje e konsiderueshme e financimit vendas është mobilizuar gjithashtu për të financuar aktivitete të lidhura me klimën. Shumica e veprimeve të përshtatjes do të duhet të menaxhohen nga qeveritë kombëtare dhe nënkombëtare përmes sistemeve të tyre të brendshme buxhetore. Prandaj, kërkohet një kuadër i fortë buxhetor i brendshëm i orientuar drejt performancës, i cili integron rreziqet klimatike dhe redukton emetimet e gazeve serrë, për të siguruar mjedisin e favorshëm për harmonizimin e financave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndryshimi është çështje ndërsektoriale. Aktivitetet e sektorit publik që lidhen me përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike shpesh janë të shpërndara nëpër ministri të ndryshme. Shpërndarja e aktiviteteve të ndryshimeve klimatike paraqet sfida për sistemin e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) për të lehtësuar planifikimin, identifikimin dhe raportimin mbi shpenzimet e ndryshimeve klimatike.

Sfidat mund të kapërcehen duke futur Etiketimin e Buxhetit Klimatik - EBK, i cili ndihmon integrimin e ndryshimeve klimatike në sistemin buxhetor për të adresuar ndikimet ekonomike, sociale dhe mjedisore të ndryshimeve klimatike duke identifikuar, klasifikuar, peshuar dhe shënuar shpenzimet përkatëse për klimën në sistemin buxhetor. Përveç kësaj, EBK-ja krijon pikën hyrëse për gjurmimin e burimeve për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ-të), të cilat janë të lidhura ngushtë me ndryshimet klimatike në përmbushjen e shumicës së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe për lehtësimin e aktiviteteve në kuadër të Kontributeve Kombëtare të Pikësnuara (KKP-të).

LINKU: [Të dish se çfarë shpenzon: Një shënim udhëzues për qeveritë për të gjurmuar financimin e ndryshimeve klimatike në buxhetet e tyre | Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim \(undp.org\)](#)

Objektivi i EBK-së është t'i mundësojë qeverisë të marrë vendime të informuara për investime, të lehtësojë integrimin më të mirë të ndryshimeve klimatike në planet kombëtare dhe nënkombëtare dhe të lejojë gjurmimin dhe monitorimin e alokimeve të burimeve që janë të rëndësishme për ndryshimet klimatike në sistemin buxhetor.

